

Sa të pavarura janë autoritetet rregullatore në Kosovë?

**Një vështrim më nga afër i
Autoriteteve Rregullatore në
Konkurrencë, Hekurudha, Telekom
dhe Energji**



Sa të pavarura janë autoritetet rregullatore në Kosovë?

**Një vështrim më nga afër i
Autoriteteve Rregullatore në
Konkurrencë, Hekurudha, Telekom
dhe Energji**

Prishtinë, Tetor 2017

Të drejtat e autorit © 2017. Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të fragmenteve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe shqyrtimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në sistem ku mund të përdoret serish, apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues incizues apo mjeti tjetër, pa lejen paraprake të D4D-së.

Përgatitur nga:

Visar Sutaj

Ky hulumtim dhe punim është bërë në bashkëpunim me Fondacionin Henrich Böll Foundation. Mendimet dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk i paraqesin mendimet dhe pikëpamjet e Fondacionit Heinrich Böll. Përmbajtja e këtij punimi është përgjegjësi e Institutit Demokraci për Zhvillim dhe në asnjë mënyre nuk reflekton pozicionin e Fondacionit Heinrich Böll Foundation.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive 5

Pasqyra e literaturës 8

Hyrje 10

Pasqyrë e kuadrit ligjor 13

Qasja e hulumtimit 15

Statusi i rregullatorit 19

Gjetjet kryesore 23

(1) Emërimet dhe mandati 24

Bazuar në cilat kritere? 26

Emërimi 27

Mandati 29

(2) Vendim-marrja 31

Bazuar në cilat kritere? 32

Kompetencat 33

Përgjegjësitë 35

Llogaridhënia 36

(3) Institucioni/Organizata 39

Bazuar në cilat kritere? 41

Burimet e financimit 42

Kontrolli buxhetor 44

Burimet njerëzore 48

Rekomandime 52

Shtojca 1: Pyetësor mbi pavarësinë e rregullatorëve 54

Lista e publikimeve 58

Shënime përfundimtare 62

Sa të pavarura janë autoritetet rregullatore në Kosovë?

Përmbledhje ekzekutive

Në demokraci, pavarësia e autoriteteve rregullatore është parakusht për forcimin e ndarjes së pushteteve dhe rregullimin e tregjeve. Mbi të gjitha, shkalla e pavarësisë së autoriteteve rregullatore i përcakton standardet e cilësisë dhe kushtet e qasjes në sektorët që rregullohen. Megjithatë, nëse u nënshtrohen ndërhyrjeve të jashtme, qofshin ato politike ose që ndërlidhen me industrinë, **qëndrueshmëria e tyre dëmtohet rëndë**. *Deri në çfarë mase autoritetet rregullatore në Kosovë janë të pavarura është çështja kryesore e preokupimit të këtij studimi.* Kjo gjykohet në bazë të **shkallës** në të cilën autoritetet janë institucionalisht, funksionalisht dhe financiarisht të pavarur nga ndërhyrja shtetërore dhe politike.

Ky raport përfshin **dimensionet më kritike** të pavarësisë rregullatore në konkurrencë, hekurudha, telekom dhe sektorin e energjisë. Ai jep një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes aktuale të performancës rregullatore dhe sfidave në sistemin rregullator bazuar mbi të dhënat e nxjerra nga ekspertët dhe zyrtarët gjatë punës për autoritetet përkatëse dhe gjetjet nga burime të besueshme, duke përfshirë raportet e auditimit të **Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)**. Autoritetet rregullatore që janë subjekt i këtij studimi përfshijnë Autoritetin Kosovar të Konkurrencës (AKK), Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARRH), Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) dhe Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE). Derisa autoritetet rregullatore kanë të përbashkëta ngjashmëri në kuptimin e përbërjes dhe rolit, ekzistojnë shumë dallime të cilat i hasim, e që gjithashtu e përshkruajnë nivelin e pavarësisë institucionale.

Ky raport është autorizuar nga **Fondacioni Heinrich Böll (FHB)**, në një përpjekje të përbashkët me Demokracinë për Zhvillim (D4D), për të adresuar çështjen e

pavarësisë rregullative në Kosovë. Ky raport kryesisht i referohet periudhës ndërmjet viteve **2012-2016**, në kontekstin e të cilit gjetjet kryesore tregojnë se autoriteteve rregullatore nuk u sigurohet një shkallë pavarësie në kryerjen e rolit të tyre.

Si rrjedhojë, gjersa legjislacioni është më i favorshëm për sektorët e rregulluar, ai nuk është thjeshtuar mjaftueshëm dhe zbatimi i tij dështon në praktikë. Nuk ka një *Ligj të veçantë për Agjencitë e Pavarura*, i cili do të vendoste një qasje të gjerë dhe standarde në lidhje me aktivitetet dhe procedurat administrative dhe rregullatore.

Gjetjet kryesore të hulumtimit tregojnë se autoritetet rregullatore janë shumë të cenueshme ndaj ndikimit politik në çështjet që lidhen me (a) emërimet dhe mandatin e anëtarëve të Bordit, (b) procesin e vendim-marrjes, dhe (c) pavarësinë e institucioneve ose të organizatave. Niveli i pavarësisë do të ndihmojë në hulumtimin e mëtejshëm të këtyre çështjeve, të cilat janë përfshirë në mënyrë të përsëritur në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian (KE). Si rrjedhojë, autoritetet rregullatore i nënshtrohen kontrollit politik kur bie fjala për emërimin e anëtarëve të Bordit. Me urdhër të partive politike, shpesh bordet janë **të paplota**, pasi që partive iu duhet më shumë kohë që t'i llogarisin dhe faktorizojnë interesat e tyre se cilin anëtar të propozojë - një përshtatje ideale që do t'i shërbente agjendës së tyre politike me koston e interesit publik.

Në kushtet e ndikimit politik dhe të pasigurisë, **vendim-marrja** vihet në rrezik! Siç tregojnë gjetjet kryesore, kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse minimalisht përmbushen. Për më tepër, Kuvendi ka dështuar në mbikëqyrjen e autoriteteve rregullatore, pa i mbajtur ato përgjegjëse për performancën e tyre. Duke mos njohur përfitimet ekonomike të ruajtjes së pavarësisë rregullatore, politikanët janë të prirë të ndërhyjnë në këto institucione. Merrni, për shembull,

kontrollin buxhetor që ushtrohet kundër autoriteteve rregullatore, duke i penguar ata që të bëjnë investime kapitale në fushat e industrisë që ata i mbikëqyrin.

Në mungesë të bordeve *apolitike* dhe të konsoliduara, e përcjellë kjo me vendim-marrje të ngadaltë si dhe me mungesë të mbikëqyrjes, autoritetet rregullatore kërkojnë reforma serioze. Ky raport synon të paraqesë një formë të matjes së pa-varësisë rregullatore në varësi si dhe të frymëzojë nisma të politikave në favor të përpjekjeve për depolitizim. Në dritën e gjetjeve të hulumtimit të përfshira në këtë raport, shteti duhet të jetë **i ndërgjegjshëm** sa i për rëndësisë së pavarësisë rregullatore. Si trajtohet kjo varet nga vullneti politik i miratimit dhe i zbatimit të politikave rregullatore që përjashtojnë ndërhyrjen politike me çdo kusht dhe në të gjitha rrethanat. Theksi fillestar duhet të vihet në emërimet e bazuara në meritat e anëtarëve të Bordit. Përveç kësaj, shteti duhet të sigurojë që resurset rregullatore të shpenzohen në mënyrë racionale dhe që të ekzistojë një ekuilibër ndërmjet autoriteteve dhe industrive.

Pasqyra e literaturës

Si pjesë e këtij studimi, është kryer një shikim tërësor i literaturës. Ai përbëhet nga një sërë burimesh vendore dhe ndërkombëtare. Secili burim ka hyperlink për qasje online në internet. Për më tepër, janë konsultuar faqet zyrtare të internetit, raportet vjetore dhe ligjet përkatëse të secilit autoritet rregullator.

Burimet vendore të janë përdorur si referencë përfshijnë si në vijim.

- Rexha, Albana. *Llogaridhënia e Agjencive të Pavarura në Kosovë: Vështrim mbi Perspektivat e Tanishme dhe Sfidat Kryesore*. GLPS. 2017.
- Ministria e Administrimit Publik. Rishikimi i Institucioneve dhe Agjencive të Kuvendit dhe Organet Qendrore të Qeverisë. Dhjetor 2016.
- Qeveria. Dialogu i Nivelit të Lartë Kosovë – BE mbi Prioritetet Kyçe – Agjenda e Reformës Evropiane (ARE). Nëntor 2016.
- Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Bruksel. Nëntor 2016.
- Kuvendi. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Kuvendit, Qeverisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Gusht 2016.
- Kuvendi. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Kuvendit, Qeverisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Gusht 2016.
- Instituti GAP. Institucionet dhe Agjencitë e Pavarura – Punësimi, Sistemi i Pagave, Organizimi i Brendshëm dhe Llogaridhënia. Korrik 2016.
- Abazi, Dardan & Burim Ejupi. Funksionalizimi i

Agjencive të Pavarura: Mundësitë për Shkrirje, Mbikëqyrje të Shtuar dhe Ekuilibër të Pavarësisë dhe Llogaridhënies. INDEP. 2016.

- Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). Raporti i Vlerësimit të Raportit 2014. Raport i SIGMA-s. 2014.
- Qeveria. Rregullorja nr. 06/2015 për Regjistrin Qendror të Llojeve të Lejeve dhe Licencave. Nenet 1-11. Prill 2015.
- Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). Raport Bazik i Matjes: Kosovë. Raport i SIGMA-s. Prill 2015.

Për të pasur një perspektivë dhe të kuptuar ndërkombëtare ndaj autoriteteve rregullatore, janë konsultuar edhe shumë studime. Burimet më të dobishme ndërkombëtare të cituara janë, si vijon:

- Nunes, R., Sofia B. Nuries, Guilhermina Rego. A New Governance Model for Independent Regulatory Agencies. SRP. January 19, 2015.
- Brown, Ashley C. The Funding of Independent Regulatory Agencies. Harvard University. 2006.

Këto burime janë hulumtuar online në internet dhe janë interpretuar gjatë kryerjes së studimit dhe shkrimit të raportit përfundimtar. Me qasjen e tij të orientuar kah-veprimi, me këtë raport synohet që të kontribuohet në debatin e vazhdueshëm mbi pavarësinë e autoriteteve rregullatore dhe kërcënimet potenciale në lidhje me pavarësinë e tyre. Të gjitha burimet janë hulumtuar me qëllim të identifikimit të çështjeve më të rëndësishme në këtë fushë të studimit.

Hyrje

Gjatë 15 viteve të fundit, sektori rregullator në Kosovë është zhvilluar gjithnjë e më shumë. Me ligj, që nga viti 2003-2004 janë themeluar nëntë (9) autoritete rregullatore, si institucione të **pavarura**, transparente dhe llogaridhënëse, me qëllim të rregullimit të tregjeve/industrive të caktuara dhe të tërheqjes dhe ruajtjes së besimit të konsumatorëve dhe të investimeve. Ideja prapa rritjes së rregullatorëve ka ardhur pas liberalizimit të ish-monopoleve shtetërore dhe kalimit në ekonomitë e tregut të lirë dhe të konkurrencës. Megjithatë, kalimi tek një **shtet rregullues** nuk ka qenë aq i suksesshëm në praktikë, pasi që ndikimi politik mbi autoritetet rregullatore nuk është larguar.

Sipas vlerësimit të OECD-së, pavarësia e autoriteteve rregullatore “përgjithësisht është ruajtur në aspektin e emërimeve të kryeshefave ekzekutivë dhe anëtarëve të bordit dhe burimeve financiare”.¹ Për shembull, vonesat në emërimin e stafit të lartë janë një shembull i mirë se sa joefektive kanë qenë autoritetet rregullatore kur është fjala për parandalimin e dështimit të tregut dhe përmirësimin e mirëqenies së publikut. Sa efektive janë autoritetet rregullatore varet nga niveli i ekuilibrit që e krijon mandati i tyre ndërmjet pavarësisë nga qeveria dhe llogaridhënies ndaj publikut.

Blokada politike e mbi gjashtë (6) muajve në vitin 2014 i ilustron cenueshmëritë e rregullativës që varen nga ndikimi politik. Paaftësia e Kuvendit që të formonte Qeverinë ka ndikuar jashtëzakonisht shumë në institucionet e pavarura, duke përfshirë autoritetet rregullatore, deri në pikën ku 18 borde nuk ishin funksionale.² Ose mandatet e anëtarëve të bordit kishin skaduar dhe/ose autoriteteve rregullatore u mungonte kuorumi për të marrë vendime. Shembulli i bllokadës politike në vitin 2016 dhe vazhdimi i ndërhyrjes politike në vendim-marrje e dëmton ekzistencën e

rregullatorëve, prandaj kjo është arsyeja se pse ata nuk kanë qenë në gjendje të operojnë duke “shmangur afërsinë” dhe duke mbajtur distancën e duhur.

Kohët e fundit, Qeveria ka përcaktuar një agjendë reformash për ndërrimin e *status quo*-s për ta bërë rregullativën më efektive. Në përpjekjet e përbashkëta me Komisionin Evropian (KE), ajo ka përcaktuar veprime prioritare në përputhje me Agjendën Evropiane të Reformës (AER), në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe sektorin e biznesit. AER përfshin tre prioritete afatshkurtra që lidhen me entet rregullatore ku përfshihen: (1) qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, (2) klima e konkurrencës dhe e investimeve, dhe (3) arsimi dhe punësimi.³ Agjenda e reformës e cila i është dorëzuar Komisionit në vitin 2016 duhet të shihet e ndërlidhur me strategjitë ose programet ekzistuese siç janë Strategjia për Rregullim më të Mirë (2014-2020) dhe Programi i Reformës Ekonomike (2017). Kjo Strategji është rishikuar në vitin 2016 dhe është miratuar versioni i ri për vitet 2017-2021.

Programi i Reformës Ekonomike (PRE) mbetet dokumenti kryesor i politikave për orientimin e reformave makroekonomike, në aspektin e marrjes së përfitimeve ekonomike dhe politike nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) që ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2016. PRE sistemin rregullator funksional do ta bazonte në politikat e zhvillimit me qëllim thjeshtimin e legjislacionit dhe futjen e një sistemi vlerësimi të rregullativës.⁴ Kjo nismë e politikës i ka pasuar strategjitë e mëparshme si Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit (2016-2021).

Në katër (4) vitet e fundit, qasja e politikave të shtetit ndaj rregullimit ka qenë proaktive. Në maj të vitit 2014, është miratuar **Strategjia e Rregullimit më të Mirë** (2014-2020). Kjo Strategji përcakton reduktimin e ngarkesave administrative si qëllimin kryesor të reformimit të sistemit rregullator në vend.⁵ Shmangia e ngarkesave të

panevojshme është gjithashtu pjesë e Strategjisë së ri-strukturuar të Rregullimit më të Mirë(2017-2021).⁶ Në vitin 2015, është miratuar Rregullorja Nr. 06/2015 për Regjistrin Qendror të Llojeve të Lejeve dhe Licencave. Kjo rregullore përcakton procedurat për çdo autoritet qendror përgjegjës për krijimin, ruajtjen dhe raportimin e informatave mbi llojet e lejeve dhe të licencave që ato kanë lëshuar.⁷

Megjithatë, përkundër shumë nismave dhe strategjive të politikave të ndërmarra nga Qeveria në katër vitet e fundit, ende nuk ka mekanizma të vendosura në praktikë për “reduktimin sistematik të burokracive”.⁸ Vlerësimi i Ndikimit Rregullator (VNR) dhe iniciativat e tjera të planifikuara lidhur me thjeshtimet administrative nuk janë realizuar.⁹ VNR është një term që përdoret për të përshkruar procesin e analizës sistematike të përfitimeve dhe kostove të një rregulloreje të re, me synim përmirësimin e cilësisë së politikave rregullatore. Se deri në çfarë pike ka arritur rregullimin në ecuri e sipër dhe sa është prekur nga ndikimi politik do të përpiqemi ta zbulojmë në pjesët e mbetura të këtij raporti, duke aluduar në gjetjet e kërkimit që kryesisht përfshijnë elementet e pavarësisë në autoritetet rregullatore. Raporti do të përqendrohet vetëm në pavarësinë nga presionet politike dhe nuk do t'i trajtojë çështje të rëndësishme nga të cilat autoritetet rregullatore duhet të jenë po ashtu të pavarura, si ato të sektorit privat.

Është e rëndësishme të theksohet se pavarësia nuk nënkupton që agjencitë rregullatore nuk duhet të mbahen përgjegjëse nga ndonjë institucion tjetër, përveç qeverisë. Sipas ligjit, agjencitë e pavarura janë të lira nga Qeveria dhe në vend të kësaj ato japin llogari para popullit të Kosovës, përmes përfaqësuesve të tyre në Kuvend. Është përgjegjësi e Kuvendit që të sigurojë që agjencitë rregullatore t'i përmbushin mandatet e tyre sipas ligjit. Në përgjigje të gjetjeve të raportuara nga agjencitë rregullatore, Kuvendi është përgjegjës që të garantojë proceset e emërimit dhe

pavarësinë institucionale në emër të interesit publik.

Pasqyrë e kuadrit ligjor

Në Kosovë, kuadri ligjor në lidhje me autoritetet rregullatore është i rregulluar sipas Kushtetutës. Në pajtim me **nenin 119**, duhet të krijohen rregullatorë të pavarur të tregut, “ku vetëm tregu nuk mund të mbrojë në masë të mjaftueshme interesin publik”¹⁰. Ky nen është ideuar që të vendos parimet juridike të krijimit të marrëdhënieve dhe të zhvillimit ekonomik, në favor të një ekonomie të tregut të lirë ku nuk ka **pozitë dominuese** që do të mund të impononte kufizime ndaj konkurrencës dhe mbrojtjes së konsumatorit. Autoritetet rregullatore njihen si **agjenci të pavarura** të krijuara nga Kushtetuta dhe Kuvendi. Secili autoritet krijohet me një ligj të veçantë, bazuar në **nenin 142** të Kushtetutës, që përcakton parimin e pavarësisë për krijimin e agjencive. Si të tilla, autoriteteve rregullatore u garantohet e drejta për të funksionuar në mënyrë të pavarur nën buxhetin e tyre vetanak.

Në Kosovë, autoritetet rregullatore janë institucione publike përgjegjëse për ushtrimin e autoritetit në shumë fusha të veprimtarisë njerëzore në cilësinë si rregullues. Sipas ligjit, autoritetet rregullatore janë të pavarura nga qeveria dhe trajtojnë fusha që kanë të bëjnë me një sektor të caktuar ekonomik dhe kanë tendencë të trajtojnë një numër aspektesh që do të vlerësohen gjatë këtij studimi: zgjedhja dhe përgjegjësitë e Bordit, menaxhimi i tyre dhe trupi mbikëqyrës, kompetencat dhe detyrimet ligjore, buxheti dhe raportimi. Përveç kësaj, autoritetet rregullatore gjithashtu nxjerrin politika dhe udhëzime lidhur me vendimet që ato marrin. Si instrument kuazi-ligjor, ato duhet të promovojnë qëndrueshmërinë dhe efikasitetin në vendim-marrje.

Në përgjithësi, kuadri ligjor është i favorshëm për autoritetet rregullatore dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.¹¹ Megjithatë, nuk ekziston një ligj i veçantë

që i rregullon autoritetet rregullatore dhe/ose agjencitë e pavarura, që të përcaktojë parimet për “*krijimin, organizimin, mbikëqyrjen, llogaridhënien, mandatin, aranzhimet e qeverisjes ose heqjen e agjencive* [autoriteteve rregullatore].”¹²Për më tepër, legjislacioni dytësor nuk është konsoliduar. Në mungesë të një kuadri ligjor të konsoliduar, rregullatorët funksionojnë brenda kompetencave të deleguara nga legjislativi dhe mbeten objekt i qëllimeve afatgjata të politikave. Çdo autoritet rregullator funksionon sipas një ligji të veçantë, pra **AKK** sipas *Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës*, **ARH** sipas *Ligjit për Hekurudhat e Kosovës*, **ARKEP** sipas *Ligjit për Komunikimet Elektronike* dhe **ZRRE** sipas *Ligjit për Rregullatorin e Energjisë*.

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (Ligji nr. 03/L-229) përcakton rregullat dhe procedurat për mbrojtjen e konkurrencës në treg, si dhe kompetencat dhe organizimin e **Autoritetit për Mbrojtjen e Konkurrencës ose Autoritetit Rregullativ të Kosovës**.¹³ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës zbatohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ndërmarrjet si brenda apo edhe jashtë Kosovës.¹⁴ Ky Ligj përfshin të gjitha agjencitë e pavarura rregullatore në Kosovë, duke përfshirë ato që janë pjesë e këtij studimi kërkimor. Si rrjedhojë, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) është përgjegjës për krijimin e kushteve për konkurrencë dhe zhvillim efektiv në fushën ose sektorin e transportit, të telekomit dhe të energjisë. Integriteti në konkurrencë varet nga niveli i fuqive në treg. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, një ndërmarrje ka pozicion dominues nëse (si furnizues ose blerës i mallrave dhe i shërbimeve të caktuara) nuk i nënshtrohet një **konkurrence të ndershme në treg** dhe ka **fuqi** të rëndësishme në **treg**.¹⁵ Nëse në treg tejkalohet pjesa prej 40 përqind, një ndërmarrje konsiderohet se ka pozitë dominuese në treg. Kjo rregull zbatohet për dy ose më shumë ndërmarrje që funksionojnë së bashku në treg.

Ligji për Hekurudhat e Kosovës (Ligji nr. 04/L-063) është ideuar me qëllim të rregullimit, zhvillimit dhe përmirësimit të sistemit hekurudhor në vend, duke krijuar qasje të hapur dhe të ndershme ndaj operatorëve dhe duke ofruar shërbime në sektorin hekurudhor.¹⁶ Ligji përcakton funksionet dhe kompetencat shtetërore dhe të institucioneve hekurudhore, si dhe operacionet dhe shërbimet që ofrohen nga sistemet hekurudhore. **Ligji për Komunikimet Elektronike** (Ligji nr. 04/L-109) rregullon veprimtaritë e komunikimit elektronik bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase dhe duke siguruar ofrimin e shërbimeve të duhura dhe adekuate në territorin e Kosovës.¹⁷ **Ligji për Energjinë** (Ligji nr. 05/L-081) ka përcaktuar rregullat me të cilat rregullohen veprimtaritë në sektorin e energjisë, me objektivin e arritjes së një furnizimi me energjisë të sigurt, të sigurt nga rreziqet dhe të kualitetit të lartë, si dhe për ofrimin e kushteve për një treg funksional e të hapur të energjisë, si dhe për të promovuar përdorimin më efikas të energjisë dhe për të përmirësuar mbrojtjen e mjedisit gjatë veprimtarive energjetike.¹⁸

Qasja e hulumtimit

Termi pavarësi përfshin një gamë të gjerë të aranzhimeve institucionale. Hulumtimi është ideuar mbi bazën e një pyetësori në formë interviste që përfaqëson një mostër të çështjeve dhe të të anketuarve, që përfshin disa tregues, si: (1) emërimet dhe mandati, (2) vendim-marrja, dhe (3) pavarësia e institucioneve ose e organizatave. Hulumtimi synon të japë një pasqyrë të **gjendjes aktuale** dhe sfidave kryesore, përmes analizave dhe rasteve studimore. Ai gjithashtu ofron informacion për Qeverinë që të ketë parasysh kur të vendosë se çfarë të bëjë lidhur me trajtimin e çështjeve shqetësuese që lidhen me pavarësinë rregullatore. Përveç kësaj, do të sigurojë bazë për diskutimin e marrëdhënieve ndërmjet koncepteve ligjore dhe praktike

në lidhje me autoritetet rregullatore, duke trajtuar pyetjen kryesore se deri në çfarë shkalle autoritetet rregullatore janë të pavarura në praktikë.

Ideja e hulumtimit është matja dhe krahasimi i pavarësisë relative të autoriteteve rregullatore përmes vlerësimit të ngjashmërive dhe dallimeve, në kontekstin e një mostre të standardizuar dhe treguesve të standardizuar të matjes. Qasja përbëhet nga analiza cilësore e pavarësisë së autoriteteve rregullatore. Në hulumtim një theks i shtuar vihet në rëndësinë e përvojës subjektive të individëve që janë të përfshirë në lëmin e sistemeve rregullatore. Hulumtimi është i orientuar kah procesi dhe jep një perspektivë të brendshme përmes teknikave kërkimore/hulumtuese standarde, duke përfshirë hulumtimin në tavolinë dhe punën në terren. Këto metoda kanë ndihmuar që raporti të ketë një pasqyrë të gjerë sa u përket autoriteteve rregullatore në vend.

Puna në terren përfshiu procesin e mbledhjes së informacionit/të të dhënave nga intervistat dhe kërkesat e parashtruara ndaj institucioneve përkatëse sa u përket të dhënave mbi shpenzimet financiare, burimet njerëzore, trendet e licencimit dhe kështu me radhë. Janë kryer gjithsej gjashtë intervista me ekspertë dhe përfaqësues të institucioneve përkatëse duke përdorur një pyetësor të strukturuar gjatë dizajnit dhe hartimit të hulumtimit. Kjo pjesë e hulumtimit ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave dhe analizimin e informatave në format jo-numerik.

Fillimisht, është hartuar pyetësori dhe janë përzgjedhur katër (4) autoritete rregullatore. Mostra përbëhet nga **drejtuesit** ose **drejtorët ekzekutivë** të autoriteteve rregullatore të pikë-synuara, duke përfshirë Autoritetin Kosovar të Konkurrencës (AKK), Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH), Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) dhe Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE). Pyetësori është

paraqitur në **Shtojcën 1**. Këto institucione rregullatore janë zgjedhur pasi ato mbulojnë dy fusha prioritare të Agjendës Evropiane të Reformës (AER) në Kosovë, të cilat janë: (1) Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit, dhe (2) Konkurrenca dhe Klima e Investimeve.

Modeli i pyetësorit është dizajnuar duke përdorur modelin AKF (Johannsen, 2003), projekt i financuar nga Programi Hulumtues për Energjinë dhe Këshilli Danez për Trajnime dhe Hulumtime. Ky studim i veçantë çoi në një raport të mesëm të analizës së Rregullatorëve të Energjisë në tetë (8) vende evropiane. Sidoqoftë, studimi është shfrytëzuar dhe interpretuar në kontekst lokal për t'ju përshtatur nevojave të studimit. Këtë herë ai përfshin autoritetet rregullatore të shumta. Ai po ashtu është modifikuar për të matur nivelin e pavarësisë nga perspektiva praktike ose e sjelljes. Modeli origjinal i studimit është përshtatur për të matur rregullatorët e energjisë vetëm nga këndvështrimi ligjor. Për këtë studim, pyetësi është përdorur për intervistimin e të anketuarve, pa bërë studim për ta, ashtu siç ka ndodhur në të kaluarën. Në këtë mënyrë, mund të kapeshin më shumë të dhëna në aspektet praktike duke u përpjekur të kenë kuptim se si autoritetet rregullatore të pa-varura janë në realitet.

Të dhënat e mbledhura nga intervistat vënë theks të veçantë në pavarësinë e rregullatorëve. Të dhënat janë krahasuar dhe validuar përmes intervistimit të të anketuarve shtesë, duke përfshirë zyrtarët hulumtues të disa organizatave të shoqërisë civile, të cilët kanë njohuri të specializuara mbi sistemet rregullatore në vend. Këto organizata të shoqërisë civile përfshijnë *Institutin për Zhvillimin e Politikave* (INDEP), *Institutin GAP dhe Lensin*. Të anketuarit e tjerë janë gjithashtu **ekspertë rregullatorë** anonimë, zyrtarë nga institucionet përkatëse që mbikëqyrin autoritetet rregullative, duke përfshirë Auditorin e Përgjithshëm të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) dhe Zyrtarin Ndërlidhës të Komitetit për Zhvillim Ekonomik,

Infrastrukturë, Tregti dhe Industri (CEDITI).

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është një organ profesional dhe i pavarur përgjegjës për promovimin e standardeve të larta të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në menaxhimin financiar të administratës publike në Kosovë. Ajo kryen auditime vjetore të pavarura të të gjitha enteve duke përfshirë autoritetet rregullatore që marrin mbështetje financiare nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK). Raportet e auditimit përdoren më shumë për gjetjet sa i përket treguesit të fundit për të vlerësuar pavarësinë financiare të autoriteteve rregullatore kur është fjala për burimet e financimit dhe kontrollin buxhetor.

Pikët për çdo tregues tematik bazohet në vlerësimin e rëndësisë së tyre relative. Vlerat e pikave përdoren për të vlerësuar praktikën rregullatore siç janë emërimet, vendim-marrja dhe pavarësia e organizatës. Sapo u përcaktuan këto praktika, u bë i mundur krijimi i një rangimit të përgjithshëm sa i përket pavarësisë institucionale të autoriteteve rregullatore bazuar në një fokus grup që ka ndihmuar në testimin dhe validimin e të gjeturave të hulumtimit si dhe të rezultateve përfundimtare. Këto rangime paraqesin gjendjen aktuale sa i përket të menduarit dhe vlerësimit. Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe të vlerësimit, për secilin tregues është hartuar një listë me praktikën e rekomanduar.

Vlerësimi me pikë: Është krijuar një indeks në të cilin treguesit e ndryshëm janë krahasuar kundrejt njëri-tjetrit për të krijuar një shprehje të vetme sa i përket shkallës së pavarësisë së rregullatorit. Prandaj, ky studim shqyrton se si rregullat formale funksionojnë në praktikë. Qëllimi kryesor i indeksimit të gjetjeve të hulumtimit ka qenë krijimi i një pasqyre të të dhënave për sa i përket nivelit të pavarësisë. Studimi pretendon se indeksi tregon realitetin në aspektin e nivelit të pavarësisë rregullative. Ajo që me anë të studimit shpresohet të bëhet me indeksin është të demonstron se sa

të ndryshëm ose të ngjashëm shfaqen autoritetet rregullatore bazuar në vlerësimin e raporteve kredibile, intervistave në terren dhe fokus grupeve.

Megjithatë, këtyre rezultateve nuk duhet t'u jepet shumë rëndësi pasi që paraqiten ngjashmëri të konsiderueshme tek autoritetet rregullatore në secilën nga katër dimensionet e matura - si në aspektin ligjor, ashtu edhe në atë praktik. Faktorë të caktuar si çështjet administrative dhe përbërja e politikave janë jashtë fushëveprimit të analizës së hulumtimit.

Statusi i rregullatorit

Statusi dhe objektivat e autoriteteve rregullative janë shprehur qartë në legjislacion dhe në deklaratat e misionit të secilës organizatë. Sipas ligjit, autoritetet rregullatore rëndom vendosen për të zbatuar standardet e sigurisë dhe/ose për të mbikëqyrur shfrytëzimin e të mirave publike, si dhe për të rregulluar sektorë të veçantë. Ata kanë autoritet të paraparë me ligj për të kryer funksionet e tyre me mbikëqyrje nga dega legjislative. Secili objektivi dhe kompetencë e autoriteteve rregullatore gjendet në ligje të veçanta. Secila agjenci rregullatore angazhohet për promovimin e së paku katër objektivave të ndërlidhura ngushtë. Bazuar në këto objektiva, autoritetet rregullatore vendosin për përparësitë, proceset dhe kufizimet për performancën e tyre. Në tabelën më poshtë tregohen se cilat objektiva i përmbush secili nga autoritetet rregullatore.

Sa të pavarura janë autoritetet rregullatore në Kosovë?

Objektivat	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit	Zyra e Rregullatorit për Energji
Mbrojtja e konsumatorit	X	X	X	X
Efikasiteti ekonomik	X	X	X	X
Konkurrenca	X	X	X	X
Transparenca e tregut	X	X	X	X
Miqësor me mjedisin			X	
I përgjegjshëm në aspektin social			X	
Siguria e furnizimit	X	X	X	X
Të tjera				

Rregullat që përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet autoriteteve rregullatore dhe industrisë së rregulluar tregojnë një pasqyrë të përzier të marrëdhënieve që shmangin afërsinë dhe mbajnë distancën e duhur ndërmjet dy palëve në praktikë. Nuk ekziston një model i vetëm të cilit i përmbahen të gjitha autoritetet rregullatore. Roli i AKK-së sipas Ligjit për Konkurrencën dhe deklaratën e misionit është që të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë së tregut duke ndaluar veprimet që e kufizojnë dhe e ndalojnë konkurrencën. AKK-së i kërkohet që t'i përcaktojë ato veprime që përfshijnë veprimet anti-kartele, shpërdorimin me pozitën dominuese, dhe bashkimet ose koncentrimet e sipërmarrjeve të tilla.¹⁹ AKK-ja është përgjegjëse për detyrat e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës për të cilat ajo i përgjigjet Kuvendit.²⁰ Struktura e brendshme dhe metodat e punës dhe çështjet e tjera të rëndësishme për punën e autoritetit

rregullohen me statut, i cili propozohet nga Autoriteti i Konkurrencës dhe miratohet nga Kuvendi.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) është një agjenci e pavarur rregullatore (APR) përgjegjëse për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit hekurudhor në Kosovë që vepron si organ licencues, organ përgjegjës për çështjet e ndërveprimit dhe subjektet njoftuese, organ për rregullimin e tregut hekurudhor dhe organ për sigurinë hekurudhore dhe kompetenca të tjera që janë dhënë në bazë të këtij ligji.²¹ Në Kosovë operojnë vetëm dy kompani hekurudhore publike, (1) menaxhimi i infrastrukturës hekurudhore (INFRAKOS), dhe (1) operacionet e transportit hekurudhor (TRAINKOS).²² Infrastruktura hekurudhore shtetërore në Kosovë menaxhohet nga Hekurudhat e Kosovës Sh.A, INFRAKOS.²³

Roli i ARKEP-it (*që i referohemi edhe si Autoriteti Rregullativ i Telekomit ose ART*) sipas Ligjit për Komunikimet Elektronike dhe deklaratës së misionit është që të zhvillojë industrinë e telekomunikacionit dhe të informacionit përmes promovimit të hyrjes në treg, konkurrencës së shëndoshë dhe zhvillimit të teknologjive dhe të shërbimeve moderne.²⁴ Mbrojtja e konsumatorit dhe qeverisja e mirë po ashtu janë pjesë e misionit të organizatës. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) është një agjenci e pavarur rregullatore, përgjegjëse për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare.²⁵

ZRRE sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe deklaratën e misionit është përgjegjës për rregullimin e energjisë elektrike, të ngrohjes qendrore dhe gazit natyror. ZRRE përcakton kornizë rregullative për një treg energjie transparent dhe jo diskriminues bazuar në ekonominë e tregut të lirë dhe në konkurrencë.²⁶ Në mesin e shumë prej kompetencave të saj ligjore, ZRRE-ja, për të përmbushur

detyrimet e saj, ushtron shumë kompetenca licencimi, si dhënia, modifikimi, pezullimi, transferimi dhe tërheqja e licencave. Gjithashtu miraton tarifën dhe metodologjitë për rregullimin e sektorit të energjisë, përveç dhënies së lejeve për ndërtimin dhe operimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe të sistemeve të tubacionit.

Kur bëhet fjalë për dallimet sa i përket dizajnit institucional, struktura e bordeve dhe personeli hasen si karakteristikat më të rëndësishme. Institucionet përgjegjëse për vendim-marrje në agjencitë rregullatore janë bordet ose komisionet. Përveç ARH-së, çdo bord ka autoritet ekzekutiv për të ekzekutuar dhe zbatuar ligjet në fuqi. Struktura e bordit është paksa e ndryshme. AKK-ja përbëhet nga një *Komision për Mbrojtjen e Konkurrencës*, që është një organ kolegjal që e menaxhon punën e autoritetit. Ndërsa ARH-ja përbëhet nga një bord pa fuqi ekzekutive, bordet e ARKEP-it dhe të ZRRE-së kanë kompetenca të plota ekzekutive. Sa i përket personelit, autoritetet rregullatore, përveç ZRRE-së, rekrutojnë, mbajnë dhe promovojnë shërbyesit civilë sipas Ligjit për Shërbimin Civil.

Gjetjet kryesore

Kjo pjesë jep një pasqyrë të përgjithshme të gjetjeve kryesore të hulumtimit në lidhje me nivelin e pavarësisë institucionale në autoritetet rregullatore. Gjetjet janë organizuar në tri pjesë, për të hedhur dritë mbi aspekte të ndryshme të agjencive rregullatore dhe pavarësinë e tyre institucionale. Në nën-pjesët e mëposhtme, të dhënat paraqiten me komentet e të anketuarve dhe interpretim të të dhënave. Nga pjesa e mëparshme, janë cekur shkurtimisht, **statusi dhe misioni** i autoriteteve rregullatore. Se deri në çfarë mase përcillen ato në praktikë është pyetja të cilën e trajtojnë gjetjet e hulumtimit në këtë pjesë?

Në përgjithësi, gjetjet kryesore tregojnë se autoritetet rregullatore i nënshtrohen kontrollit politik kur është fjala për emërimin e anëtarëve të bordit. Me urdhër të partive politike, shpesh bordet janë **të paplota** pasi që partive u duhet më shumë kohë për llogaritjen dhe faktorizimin e interesave të tyre. Kur interesat politike vihen në rrezik, atëherë kjo e dëmton procesin e vendim-marrjes. Në shumicën e rasteve, anëtarët e bordit nuk i përmbushin kushtet teknike për të marrë vendime, përderisa ata i përfaqësojnë interesat e partive politike. Kjo është arsyeja se pse autoritetet rregullatore nuk arrijnë ta ushtrojnë rolin e tyre.

Mungesa e llogaridhënies është një tjetër gjetje shqetësuese. Kuvendi jo vetëm që nuk organizon proces të drejtë dhe konkurrues për emërimin e anëtarëve të bordit. Por, kur ata të emërohen, nuk arrin t'i mbajë përgjegjës. Raportet vjetore që i dorëzohen Kuvendit për diskutim dhe miratim, rrallëherë debatohen në mënyrë të plotë. Në rastet kur kritikohet performanca e autoriteteve rregullatore, nuk ndërmerret asnjë veprim disiplinor. Në ndonjë rast, kur autoriteti rregullator performon më mirë, nuk ka asnjë mekanizëm shpërblimi, p.sh. rritja e mbështetjes buxhetore

ose e autonomisë financiare për autoritetet rregullatore me qëllim të avancimit të tregut apo industrive gjegjëse.

Për të rritur llogaridhënien në këtë drejtim, Kuvendi dhe Qeveria me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi (MiM) në vitin 2016. Kjo marrëveshje formale është ideuar për të mbështetur përpjekjet e përbashkëta për të siguruar që "të emërohen drejtues të fortë, të pavarur dhe profesional të institucioneve dhe të organeve publike përmes një procesi të drejtë dhe transparent të rekrutimit".²⁷

Ambasada Britanike do t'u ndihmojë institucioneve të Kosovës në procesin e rekrutimit përmes angazhimit të një partneri zbatues. Roli i partnerit zbatues do të jetë **këshillimi dhe mentorimi** i institucioneve shtetërore, duke përfshirë autoritetet rregullatore, për rekrutimin e pozitave të nivelit të lartë siç janë anëtarët e bordeve.²⁸ Se sa efektiv është Memorandumi i Mirëkuptimit në praktikë është e herët të thuhet, pasi që asnjë autoritet rregullator nuk u është nënshtruar dispozitave të vendosura në këtë marrëveshje. ZRRE-ja i është nënshtruar procesit të rekrutimit të këshilluar dhe mentoruar nga britanikët, megjithatë, procesi i emërimit ende nuk është finalizuar dhe si rrjedhojë, do të ishte e vështirë të tregohen rezultatet.

(1) Emërimet dhe mandati

Pavarësia rregullatore nga pushteti politik është element kyç i një sistemi rregullator efektiv. Në veçanti, emërimi dhe mandati në autoritetet rregullatore është parakusht që autoritetet rregullatore të ushtrojnë autonominë e plotë nga dega ekzekutive. Ky tregues nënkupton që emërimi i anëtarëve të bordit ose të komisionit të bazohet në merita dhe kritere profesionale. Asnjë ndërhyrje nuk duhet të ushtrohet në procesin e përzgjedhjes. Në asnjë mënyrë anëtarët e bordit nuk duhet t'u përkasin partive politike dhe të mbështeten në preferencat politike në realizimin e

qëllimeve. Shkalla në të cilën bordet janë të pavarura përfundimisht e përcaktojnë nivelin e funksionalitetit të autoriteteve rregullatore.

Në shkallën prej 1 deri në 10, sa i pavarur do të thoni ju është kryetari/bordi i autoritetit rregullator sipas emërimit dhe statusit formal? (1 jo i pavarur dhe 10 plotësisht i pavarur)

Në shkallën 1 deri në 10, sa të pavarur do të thoshit ju janë shefi/bordi i autoritetit rregullator sipas emërimit dhe statusit formal ? (1 jo i pavarur dhe 10 plotësisht i pavarur)	Bazuar në cilat kritere?
--	--------------------------

Emërimi & Mandati	0.1	0.2	0.3	0.4	0.5	0.6	0.7	0.8	0.8	0.9	1.0
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	X	X	X								
Autoriteti Rregullator i Hekurudhave	X	X	X	X							
Autoriteti Rregullator i Telekomit	X	X	X	X	X	X					
Autoriteti Rregullator i Energjisë	X	X	X	X							

Në përgjithësi, autoritetet rregullatore nuk janë të pavarura sa i përket përbërjes së anëtarësisë së bordit/komisionit. Në këtë drejtim, ekzistojnë dy dimensione që mund të masin nivelin e pavarësisë - emërimi dhe mandati i bordit. Ato masin shkallën në të cilën autoritetet rregullatore ndikohen nga jashtë. Si rrjedhojë, të gjitha autoritetet rregullative i nënshtrohen ndikimit politik. Procesi i përzgjedhjes së autoriteteve rregullatore nuk bazohet në merita dhe është shumë politik! Anëtarët e bordit nuk emërohen në bazë të meritave profesionale dhe janë të lidhur me partitë politike. Dinamikat e emërimit të anëtarëve të bordit që varësisht nga ndërhyrjet e jashtme e kanë ngadalësuar procesin e vendim-marrjes në sektorët rregullatorë. Shpesh ndodh që

nëse anëtarët e bordit që propozohen në Kuvend nuk votohen në përpjekjen e parë, ata propozohen për t'u votuar përsëri. Kohë pas kohe, ose qeveria ose legjislativi i vë ata në seancën plenare derisa në fund ata të emërohen.

Pavarësia është një kusht formal për bordin dhe Zyrën Ekzekutive të autoriteteve rregullatore. Megjithatë, në praktikë kjo gati nuk është e vërtetë. Siç tregohet në Raportin e fundit të Progresit të KE-së (2016) se emërimet në agjencitë e pavarura duke përfshirë autoritetet rregullatore shpesh i ishin nënshtruar ndikimit politik.²⁹ Në katër vitet e fundit, shumica e rregullatorëve nuk kishin borde të konsoliduara, që si rrjedhojë shumë prej tyre nuk kishin kuorum për vendim-marrje. Në vitet e fundit, Kuvendi ka arritur të plotësojë disa borde të rregullatorëve, p.sh. Autoritetit Kosovar i Konkurrencës (AKK), Autoriteti Rregullativ për Komunikimet Elektronike dhe Postare (ARKEP). Megjithatë, aktualisht Autoriteti Rregullator për Energjinë (ARE) nuk ka një bord të plotë!

Bazuar në cilat kritere?

Kriteret për përcaktimin e nivelit të pavarësisë në menaxhmentin e lartë të autoriteteve rregullatore bazohen në këtë hulumtim dhe në raportet për vendin, duke përfshirë Raportin e Progresit të Komisionit Evropian (KE). KE-ja, në Raportin e fundit të Progresit (2016), ka ngritur shqetësime serioze sa i përket mungesës së pavarësisë dhe ekspertizës në procesin e emërimit të anëtarëve të bordeve të autoriteteve rregullatore. Si rrjedhojë, emërimet në sektorin e hekurudhave³⁰ dhe atë të energjisë³¹ nuk ishin meritore dhe në përputhje me legjislacionin. Pavarësia e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) është minuar nga ndërhyrjet politike, kapaciteti i ulët administrativ dhe mungesa e burimeve njerëzore.

Emërimi

Emërimi i anëtarëve të bordit bëhet përmes konkursit. Qeveria përzgjedh një listë të ngushtë kandidatësh dhe i dërgon emrat në Kuvend për votën e miratimit. Fakti që Kuvendi nuk mund t'i kthejë emrat e propozuar është një lloj kontrolli nga qeveria pasi që fakt ajo i ka përzgjedhur individët e saj që të emërohen. Për disa autoritete rregullatore, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) luan një rol të rëndësishëm në lehtësimin e këtij procesi përzgjedhës (p.sh. shpallja e thirrjes). Kryetari i disa autoriteteve rregullative është gjithashtu anëtar i bordit, siç është rasti me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës (AKK).

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri (KZHEITI) i Kuvendit është po ashtu përgjegjës për shqyrtimin e aplikantëve para se ata të dërgohen në Kuvend për **votën e miratimit**. Kjo është vetëm në rast se Kuvendi zhvillon konkursin e hapur dhe pastaj Komisioni i interviston kandidatët e që janë futur në listën e ngushtë. Procesi i shqyrtimit nga Komisioni shpesh përfshin intervistimin e kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë. Në këtë drejtim, Komisioni mund të luajë një rol *de jure* duke kufizuar ndërhyrjen e qeverisë në proces. Ky proces mendohet të jetë shumë i rëndësishëm dhe prapë i vështirë pasi anëtarët e Komisionit kufizohen dhe ndikohen/nën presion që të zgjedhin **vetëm** nga radhët e kandidatëve që tashmë janë në listën e ngushtë të qeverisë. Në rast se qeveria zhvillon një konkurs të hapur, që rrallëherë ndodh, Kuvendi nuk ka asnjë kompetencë sa i përket përzgjedhjes së kandidatëve më të mirë përveç se të votojë për listën e propozuar.

Në përgjithësi, procesi nuk është i qartë dhe nuk i komunikohet mirë publikut dhe palëve të interesit. Thirrjet bëhen në njoftim për kohë të shkurtër dhe nuk arrijnë tek një audiencë të madhe. Megjithatë, thirrjet publike nuk bëhen për rregullatorë të veçantë, siç është ART-ja, anëtarët

e së cilës kalojnë përmes referencave qeveritare. Në shumicën e rasteve, kandidatët të cilët qeveria i fut në listë të ngushtë nuk plotësojnë kushtet për pozitën. Këto zbrazëtira në lidhje me kushtet nuk diskutohen dhe as nuk kontestohen pasi që ato rregullohen prapa dymve.³² Në shumicën e autoriteteve rregullatore, ekziston një sistem i dobët i verifikimit të kandidatëve në lidhje me konfliktet reale ose potenciale të interesit, edhe pse ka pasur raste të herë pas hershme të konfliktit të interesit që e kanë penguar zgjedhjen e anëtarëve të bordit, p.sh. kohët e fundit zgjedhjen të Kryetarit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK).³³

Gjetjet e hulumtimit tregojnë se emërimet përbëjnë një **privilegj absolut** të partisë në pushtet. Ministrat, në veçanti, përfshihen aktivisht në emërimin e anëtarëve të bordit. Sigurisht, procesi i përzgjedhjes është i mundimshëm dhe nuk ka një rrugëdalje të lehtë, pasi që në pyetje janë shumë interesa politikë. Për pjesën më të madhe, duhet më shumë kohë për t'i konsoliduar bordet, duke e minuar kështu pavarësinë dhe kredibilitetin e autoriteteve rregullatore.³⁴ Deri sot, ende ekzistojnë një numër autoritetesh rregullatore të cilëve u mungon kuorumi për vendim-marrje. Autoriteti Rregullator për Energjinë (ARE) ka vetëm dy (2) prej pesë (5) anëtarëve të bordit. Autoriteti Rregullativ i Telekomit (ART) që zyrtarisht njihet si Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) është autoriteti i vetëm rregullator (nga katër) që nuk ka hasur në probleme të natyrës së tillë pasi që bordet zgjidhen kolektivisht. Nuk ka pasur asnjë rast ku ka pasur pozitë të paplotësuar në ART.

Ndërkohë, legjislativi është kritikuar si një makinë për rekrutim politik! Nga shumë të anketuar, roli i saj është më shumë për të lehtësuar procesin politik të emërimit të anëtarëve të bordit. Zyrtarët e zgjedhur janë atje vetëm për të hedhur votën në bazë të preferencave partiake pa thënë

asnjë fjalë për zgjedhjen e kandidatëve që mund të kenë kredenciale më të forta.³⁵ Për këtë qëllim, të favorizuarit politikë përfundojnë të zgjedhur dhe jo profesionistë që kanë potencial dhe integritet më të madh për t'u dhënë autoriteteve rregullatore. Për shembull, zor se ekziston ndonjë rast kur një anëtar i mëparshëm i stafit është emëruar duke pasur parasysh përvojën e tij ose të saj të punës për autoritetin rregullator.³⁶

Mandati

Mandati i bordeve të secilit autoritet rregullativ është fiks për pesë (5) vjet. Mundësia e **riemërimit** vlen edhe për një mandat tjetër. Mandati fiks i bordit ofron mundësi të madhe për të hapur dyert për talentët e rinj për t'u angazhuar. Megjithatë, siç tregohet në pjesën e mëparshme, procesi i emërimit merr më shumë kohë në të gjitha rastet dhe postet e anëtarëve të bordit mbahen të paplotësuar. Autoritetet rregullatore nuk i mbajnë anëtarët e bordit të tyre derisa të emërohen anëtarët e rinj me përjashtim të ART-së ku anëtarët e bordit zgjidhen dhe shkarkohen kolektivisht. Legjislativi nuk garanton prurje të vazhdueshme të talenteve të reja për të ruajtur angazhimin dhe krijimtarinë e bordit.

Anëtarët e bordit dhe të zyrës ekzekutive nuk mund të mbajnë poste të tjera në qeveri gjersa janë pjesë e autoritetit rregullator. Gjithashtu, ka dispozita që i kufizojnë mundësitë e anëtarit të bordit dhe drejtorit të pranimit të një pune në industri pas përfundimit të mandatit të tyre. Për shkak të rritjes së mbikëqyrjes dhe presionit të mediave, bordet kanë qenë më të kujdesshëm sa i përket konfliktit të interesit, pasi që ata janë nën mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) për deklarimin e pasurisë dhe të të ardhurave të tyre. Ka pasur shumë raste në të kaluarën kur anëtarët e bordit ishin të përfshirë në mësimdhënie nëpër universitete. Kjo ka ndodhur më pak në katër vitet e fundit.

Kushtet e punës dhe të funksionimit të bordit rregullohen nga ligjet ekzistuese dhe rregullat e procedurës. Në veçanti, ato i rregullojnë detyrat administrative dhe ato rregullatore duke i dhënë bordit autoritetin që të aranzhojë përparësitë në mënyrë më efikase dhe që të marrë vendime në përputhje me rrethanat. Për fat të keq, kjo nuk ndodh në praktikë, duke marrë parasysh nivelin e integritetit profesional në radhët e anëtarëve të bordit. Nga këndvështrimi i Institutit GAP, “Bordevë u mungon përvoja dhe **ekspertiza** e nevojshme për të siguruar mbikëqyrje në çështjet administrative, disiplinore dhe rregullatore, si dhe t’i raportojnë Kuvendit³⁷ në emër të autoriteteve rregullatore”.

Nuk është rastësi se pse anëtarëve të bordit u duhet një kohë e gjatë për të kuptuar rolin rregullator në përputhje me detyrimet dhe ndjenjën e përgjegjësisë. Ligjet dhe rregullat e procedurës ekzistojnë për shkarkimin e çdo anëtari dhe shefi/drejtori ekzekutiv të paaftë për të kryer detyrat e veta. Kohëve të fundit, nuk ka pasur shkarkime në lidhje me performancën e dobët të anëtarëve të bordit. Kjo është për të ardhur keq, sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), duke marrë parasysh sasinë e kritikave që komuniteti ndërkombëtar ka shtruar kundër tyre se janë tepër të politizuar dhe joprofesional. Ndërkohë, vlerësimet e performancës nuk janë të zakonshme, gjë që do të kishin mundësuar reagime konstruktive për përmirësim.

Anëtarët e bordit janë të predispozuar për t’u rizgjedhur. Kjo ka bërë që shumë anëtarë të bëhen tepër “politikisht të besueshëm”.³⁸ T’i bindësh anëtarët që kanë shërbyer për një kohë gjatë që të mos rikandidohen është pothuajse e pamundur pasi që posti i tyre në bord është burimi i vetëm i të ardhurave. Gjetja e punësimit diku tjetër do të ishte po aq e vështirë. Vullneti politik për të ndryshuar *status quo*-n pothuajse nuk ekziston. Lufta midis degës ekzekutive dhe legjislative për zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të bordevë dhe plotësimin e posteve të lira përbën një bllokim

politik në vetvete. Mandati i çdo anëtari fillon në datën e emërimit nga Kuvendi.

(2) Vendim-marrja

Autoritetet rregullative ushtrojnë një rol të veçantë në rregullimin e një tregu apo sektori/industrie të caktuar. Pavarësia rregullatore është parakusht në procesin e vendim-marrjes. Sipas ligjit, autoriteteve rregullatore u jepet e drejta që të marrin vendime vetëm në **baza ligjore dhe ekonomike** e jo në preferencat politike. Secili autoritet rregullator duhet të jetë i pavarur në kryerjen e detyrave të tij. Kapja e autoriteteve rregullatore nga pushteti politik dhe ekonomik duhet të shmanget në të gjitha rrethanat. Megjithatë, kjo nuk mund të vijë në çmimin e llogaridhënies. Autoritetet rregullatore duhet të funksionojnë sipas parimeve të qeverisjes së mirë, duke monitoruar industrinë/tregjet dhe duke pasur angazhim efektiv në institucionet qeveritare.

Në shkallën prej 1 deri në 10, sa e pavarur do të thoni ju është autoriteti rregullator është në vendim-marrjen reale? (1 jo i pavarur, 10 plotësisht i pavarur)

Në praktikë, autoritetet rregullatore nuk gëzojnë pavarësi ekskluzive në vendim-marrje. KE në Raportin e fundit të Progresit (2016) ka kritikuar disa autoritete rregullatore për **vonesa ekstreme** në vendim-marrje. Sa i përket konkurrencës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) ka qenë jofunksional në vitet 2013-2014³⁹ dhe ka vazhduar të veprojë në mungesë rregulli deri në vitin 2017 kur u konsolidua bordi, duke mos e mbrojtur kështu tregun/industrinë.⁴⁰ Në sektorin hekurudhor, Autoritetit Rregullativ të Hekurudhës (ARH) i mungojnë kapacitetet administrative dhe lejon një gjendje të dobët të infrastrukturës.⁴¹ Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është kritikuar për procedura të gjata administrative të lëshimit të lejeve dhe licencave të ndryshme (p.sh. ka marrë

më shumë kohë për miratimin e licencave të furnitorëve dhe për përshtatjen e rregullave të kalimit dhe mosbalancit).⁴²

Në shkallën 1 deri në 10, sa i pavarur do të thoshit ju është autoritetit rregullator në vendim-marrje? (1 jo i pavarur dhe 10 plotësisht i pavarur)	Bazuar në cilat kritere?
--	--------------------------

Vendim-marrja	0.1	0.2	0.3	0.4	0.5	0.6	0.7	0.8	0.8	0.9	1.0
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	X	X									
Autoriteti Rregullator i Hekurudhave	X	X	X								
Autoriteti Rregullator i Telekomit	X	X	X	X	X	X					
Autoriteti Rregullator i Energjisë	X	X	X	X	X	X					

Bazuar në cilat kritere?

Kriteret për përcaktimin e nivelit të pavarësisë në vendim-marrjen e autoriteteve rregullatore bazohen në hulumtimin në terren dhe në raportet për vendin duke përfshirë Raportin e Progresit të Komisionit Evropian (KE) dhe raportet e matjes dhe të monitorimit të OECD-së. Këto burime kryesisht tregojnë se autoritetet rregullatore në përgjithësi nuk e ushtrojnë efektivisht rolin e tyre në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregjeve/industrive. Ata që kanë kompetenca më të mëdha, d.m.th., ARKEP/ART dhe ZRRE, sa i përket miratimit të tarifave, qasjes në rrjet, etj., janë të ngarkuar me përgjegjësi më të mëdha, por duket se bëjnë një punë relativisht më mirë në trajtimin e vendim-marrjes. Të dyja janë gjithashtu më transparente kur bëhet fjalë për raportimin në Kuvend.⁴³ Ndërkohë, gjersa AKK nuk ka bërë publik asnjë raport vjetor, ARH e ka bërë këtë deri në vitin 2014.

Kompetencat

Autoriteteve rregullatore u kërkohet të ofrojnë rregullim të cilësisë së lartë në sektorë ose industri specifike që ata mbikëqyrin. Në Kosovë, fushëveprimi i kompetencave rregullatore ose i detyrimet statutare kërkon që vendimet të merren për një gamë të gjerë çështjesh, duke përfshirë miratimin e tarifave, qasjen në rrjet, kompetencat e licencimit, përcaktimin e rregullave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Autoritetet rregullatore me numrin më të vogël të kompetencave janë Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) dhe Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH). Ata me numrin më të madh të kompetencave janë Autoriteti Rregullativ i Telekomit (ART) dhe Autoriteti Rregullator për Energji (ZRRE). Sipas vlerësimit të studimit hulumtues, autoritetet rregullatore janë të kapluara nga kapacitete të dobëta administrative.

Mënyra se si autoritetet rregullatore i ushtrojnë kompetencat e tyre në vendim-marrje është një fushë e rëndësishme e analizës. Është një mënyrë për të siguruar shërbime efektive dhe efikase për publikun varësisht nga sektori i rregulluar. Sa i përket konkurrencës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) ka dështuar në shumë raste të ndërmarrë hetime dhe të marrë vendime të rëndësishme për të mbrojtur tregun.⁴⁴ AKK-së i është dhënë autoriteti që patjetër të lëshojë autorizime ose vendime kundër karteleve, shpërdorimit të fuqisë dominuese, si dhe përkitazi me bashkimet dhe blerjet. Për gati dy vjet (2011-2013), bordi kishte marrë një numër jashtëzakonisht të vogël vendimesh kundër shpërdorimit të fuqisë dominuese (përcaktimi i rregullave).⁴⁵

Në sektorin e hekurudhave, ARH është në fazën e hershme të zbatimit të Direktivës 2012/34 mbi një Zonën e Vetme Hekurudhore Evropiane (qasja në rrjet).⁴⁶ Direktiva e BE-së do të ndihmonte në krijimin e kushteve të drejta dhe të hapura për qasje në shërbimet e objekteve hekurudhore.

Në fund, ARH ka licencuar operacionin e parë privat në fund të vitit 2015 (kompetencat e licencimit). Licencimi do t'i ndihmojë vendit të bëjë përparim sa i përket zbatimit të **Masave të Reformës së Lidhjes**. Legjislacioni për sigurinë hekurudhore është miratuar dhe është në fazën e hershme të zbatimit në praktikë (përcaktimi i rregullave). Megjithatë, certifikata e sigurisë ende është në pritje (e pazgjidhur).⁴⁷

Në sektorin e telekomit, autoriteti ka ndarë frekuenca shtesë për operatorët celularë ekzistues, PTK dhe IPKO Telecommunications, për shërbime 4G me cilësi më të mirë (qasje në rrjet).⁴⁸ **Në sektorin e energjisë**, nuk është bërë progres në derregullimin e çmimit të prodhimit ose në shfuqizimin e subvencionimit jo të barabartë të çmimeve midis kategorive të ndryshme të konsumatorëve.⁴⁹ Vendimet e rëndësishme për tregun e energjisë elektrike janë vonuar, duke përfshirë miratimin e licencave për furnizuesit që dëshirojnë të konkurrojnë me ata ekzistues (kompetencat e licencimit), ose përshtatjen e rregullave të kalimit dhe të çekuilibrit (përcaktimi i rregullave).⁵⁰ Ndonëse hapja e tregut është parashikuar në legjislacion, ajo nuk zbatohet në praktikë dhe konsumatorët nuk kanë mundësi t'i ndërrojnë furnizuesit e ndryshëm.⁵¹

Në autoritetet rregullatore, **zgjidhjet e kontesteve** mbeten sfida më e madhe. Ku ka disa çështje të përsëritura që kanë të bëjnë me ndikimin politik. Në konkurrencë, për shembull, disa vendime të AKK-së janë kontestuar dhe janë hedhur poshtë nga aspekti ligjor. Kështu ka ndodhur edhe në autoritetet e tjera rregullatore, ku sjellja rregullatore shkon përtej vendim-marrjes formale dhe animi dhe armiqtësia e bordit janë demonstruar lehtë. Ndonëse zgjidhja e kontesteve e rriste efikasitetin në vendim-marrje, mënyra se si merren vendimet nuk është transparente dhe llogaridhënëse. Autoritetet rregullatore që i miratojnë këto zgjidhje të kontesteve nuk japin arsyetim të detajuar.

Ndërkohë, shpesh proceset e vendim-marrjes përfundojnë në procedurat kontestimore. Procedurat e ankesave trajtohen nga gjykatat. Megjithatë, për shkak të vlerësimit të ekspertizës së autoriteteve rregullatore nga ana gjykatave, nuk ka të ngjarë që ata të rrëzojnë një vendim për shkak të ndikimit kolektiv në politika.⁵² Megjithatë, të anketuarit kanë ngritur shqetësime serioze lidhur me vendimet e gjykatës që e minojnë efektivitetin e punës së autoriteteve rregullatore. Rrjedhimisht, gjykatat marrin shumë kohë për të vendosur dhe procesi se si merren këto vendime nuk trajtohet siç duhet duke pasur parasysh mungesën e përvojës dhe të ekspertizës së tyre në marrjen me autoritetet rregullatore. Por, është jashtë fushëveprimit të këtij raporti vlerësimi i detajeve të vendimeve të gjykatave mbi autoritetet rregullatore.

Përgjegjësitë

Përgjegjësitë e autoriteteve rregullatore janë shumë të ngjashme në raport me secilin sektor. Por, faktori i përbashkët që lidhet me të gjithë, është roli i institucionit në dhënien e këshillave për politikën ose për hartimin e politikave. Sipas vlerësimit të të anketuarve, ndikimi politik i ka kufizuar autoritetet rregullatore në një masë të madhe sa i përket procesit të vendimmarrjes. Ata i konsiderojnë partitë politike si **agjentë të ndikimit** në tregjet ose industrinë e rregulluara. Rrjedhimisht, stafi profesional rrallë ndikon në politikë-bërje.

Procesi i hartimit të politikave i takon Qeverisë. Për fat të keq, qeveria nuk ka arritur të njohë përfitimet dhe vlerën e përfshirjes së agjencive rregullatore në vendim-marrje. Secili autoritet rregullator ushtron njëfarë roli këshillëdhënës formal duke i ndihmuar qeverisë në hartimin e politikave. Megjithatë, në praktikë nuk ekziston një mekanizëm i krijuar që do të mundësonte dhe do t'i frymëzonte autoritetet rregullatore që të kontribuojnë në hartimin e politikave.

Në çdo rast ka konsultime publike por nuk është definuar nëse komentet inkorporohen ose përdoren për të arritur tek një politikë të paracaktuar. Nuk ka një proces rigoroz të shqyrtimit të perspektivave potencialisht kundërshtuese nga ekspertët të cilët ndjehen të lirë të shprehin qëndrime që mund të dallojnë nga ato të bordit. Kjo krijon pasiguri, veçanërisht pasi strukturat e bordeve janë të paplota. Andaj, gjithmonë ka mungesë të iniciativës për politika. Në rast se ka ndonjë, zakonisht ajo nuk arrin të vihet në vëmendje të ministrit. Në një kuptim, ka mungesë besimi dhe respekti të ndërsjellë. Në shumicën e rasteve, bordet dhe ministrat nuk mund të arrijnë ta kuptojnë rolin e tyre.

Siç tregohet në studimin e fundit të Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), ka mungesë të ndërveprimit të shkëmbimit të informatave me rregullatorët dhe institucionet e tjera që angazhohen në të njëjtin sektor të politikave.⁵³

Llogaridhënia

Niveli i llogaridhënies së autoriteteve rregullatore ka qenë në qendër të vëmendjes dhe debatit të legjislaturës aktuale dhe të kaluar. Sipas ligjit, autoritetet rregullatore i përgjigjen Kuvendit. Në praktikë, ata i raportojnë Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri (KZHEITI). Megjithatë, mungon bashkërendimi dhe konsistenca ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë kur bëhet fjalë që autoritetet rregullatore të mbahen përgjegjëse. Për shembull, ekziston paqartësi se kush ia propozon Qeverisë për miratim buxhetet e rregullatorëve. Komisioni Evropian (KE) e ka kritikuar Kuvendin e Kosovës për dështimin në mbikëqyrjen e duhur të autoriteteve rregullatore në mesin e institucioneve dhe agjencive të tjera të pavarura. Prandaj, raportet e autoriteteve rregullatore miratohen pa diskutime të thella rreth gjetjeve.⁵⁴ Në mungesë të mandateve të qarta, dhe mekanizmave të përshtatshëm të raportimit dhe

llogaridhënies, përveç fragmentimit institucional, autoritetet rregullatore vazhdojnë të përballen me shumë probleme në aspektin e mbikëqyrjes dhe të reformës efektive.

Obligimet formale të llogaridhënies së autoritetit rregullator në raport me Qeverinë dhe Kuvendin kryesisht përbëhen nga **prezantimet e raporteve vjetore** në Kuvend për qëllime informimi dhe për të kërkuar miratimin e tyre. Është e rëndësishme të kuptohet se pavarësia e autoriteteve rregullatore nuk i bën ata të imunë ndaj monitorimit parlamentar.⁵⁵ Megjithatë, mënyra se si përgatiten dhe paraqiten raportet vjetore, tregojnë se deri në çfarë shkalle autoritetet rregullatore i përgjigjen Kuvendit.⁵⁶ Shumë shpesh, anëtarëve të Komisionit ose të KZHEITI-t u mungojnë shkathtësitë teknike dhe njohuritë për vlerësimin e raporteve vjetore dhe si rezultat, ata dështojnë t'u japin autoriteteve rregullatore reagime/komente dhe këshilla lidhur me politikën si potencial për përmirësim.⁵⁷ Komisionit i mungon edhe stafi mbështetës ose burimet “për mbikëqyrje, e veçanërisht për agjencitë rregullatore”.⁵⁸

Ndërkohë, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri (KZHEITI) në të kaluarën ka qenë jashtëzakonisht kritik ndaj disa autoriteteve rregullatore për mos paraqitjen e raporteve të detajuara vjetore. Rrjedhimisht, autoritetet rregullatore jo vetëm që nuk raportojnë në kohën e duhur, por gjithashtu japin raporte jo sistematike dhe të pakujdesshme (p.sh. raportet vjetore të AKK-së në të kaluarën). Në vitin 2014, KZHEITI ka bërë një dyzinë rekomandimesh që vënë theksin mbi nevojën që autoritetet t'i dorëzojnë raportet e tyre vjetore deri më 31 mars.⁵⁹ Megjithatë, duke pasur parasysh mungesën e stabilitetit politik dhe bllokadën në legjislaturë, këto rekomandime nuk janë zbatuar në përputhje me rrethanat deri në vitin 2017.⁶⁰ Këtë vit, disa autoritete rregullatore e kanë përmirësuar raportimin e tyre siç tregohet në procesverbalin e mbledhjes së KZHEITI-t të

arkivuara në faqen e internetit të Kuvendit të Kosovës. Për shembull, ZRRE-ja gjatë raportimit në muajin maj për vitin 2016, përmirësimet në aspektin e përmbajtjes dhe detajet e raportit janë duartrokitur nga kryetari i Komisionit.⁶¹

Problemi kryesor është se Kuvendit “i mungojnë mekanizmat e përshtatshëm për të mbikëqyrur punën e agjencive të pavarura [duke përfshirë autoritetet rregullatore]”.⁶² Raportet vjetore mbeten si i vetmi dokument të cilit legjislatura mund t'i referohet për vlerësimin e punës së autoriteteve rregullatore. Sipas një studimi të Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), përgjegjësitë e drejtpërdrejta të autoriteteve rregullatore “nuk shkojnë përtej raportimit, dhe, më tej e kufizojnë llogaridhënien, nuk ekziston një mekanizëm sanksionues në dispozicion për rastet kur raporti nuk është miratuar nga Kuvendi.”⁶³

Deri më sot, Kuvendi nuk ka qenë në gjendje të gjejë kanalet më efektive dhe mënyrat e llogaridhënies. Për fat të keq, asnjë dispozitë ligjore nuk lejon që legjislatura të mbajë përgjegjëse autoritetet rregullatore. Kuvendi nuk ka autoritet ligjor për të mos miratuar raportet, e as për të marrë masa disiplinore kundër autoritetit rregullator. Shqetësimi këtu është se çfarë ndodh nëse Kuvendi nuk i miraton raportet? Asgjë nuk ka ndodhur deri tani. Për shembull, në vitin 2014, Kuvendi nuk e kishte miratuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, por pas kësaj nuk janë marrë masa. Andaj, shkalla në të cilën bordet janë llogaridhënëse para Kuvendit dhe publikut është jashtëzakonisht i kufizuar.

Për më tepër, kur bordet nuk janë në vend, çështja e raportimit (llogaridhënies) në Kuvend është vënë në pikëpyetje. Në këtë drejtim, raporti i dërgohet Kuvendit por nuk u vu në diskutim. As Kuvendi nuk fton askënd që të paraqesë raportin. Komisioni mund të diskutojë raportin, por është vetëm një çështje për diskutim dhe asnjëherë nuk i

dërgohet Kuvendit për miratim.

Përveç kësaj, kërkohet që raportet vjetore të publikohen në faqet zyrtare të secilit autoritet rregullator. Megjithatë, jo të gjitha autoritetet rregullatore i bëjnë ato publike përmes faqes së tyre. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK)⁶⁴ dhe Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH)⁶⁵ nuk i kanë publikuar raportet e tyre vjetore në faqen e internetit. Në ndërkohë, Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP),⁶⁶ i njohur si Autoriteti i Telekomit dhe Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRrE),⁶⁷ i kanë publikuar raportet e tyre vjetore në faqet e tyre. Megjithatë, instrumenti për koordinim, qoftë memorandum mirëkuptimi ose marrëveshjet formale, nuk publikohen. Për shembull, memorandumimi i mirëkuptimit mund të jetë i dobishëm në saktësimin e kushteve që autoritetet rregullatore duhet t'i përmbushin në zbatimin dhe performancën e tyre.

(3) Institucioni/Organizata

Pavarësia financiare dhe organizative është parakusht për autoritetet rregullatore që të ushtrojnë autonominë e plotë operative nga dega ekzekutive. Ky **tregues** do të thotë që autoritetit rregullator i janë dhënë fonde të mjaftueshme për të kryer funksionet e tij dhe nuk mund të kërcënohet nga Qeveria, se Qeveria do t'ia zvogëlojë ose tërheqë fondet në mënyrë arbitrare. Andaj, ata gjithashtu duhet të jenë financiarisht llogaridhënës për fondet që marrin, pa iu nënshtruar kontrollit politik ose ndikimit të palëve të tjera të interesit. E njëjta rregull vlen edhe për organizatën, duke treguar se autoritetet rregullatore nuk duhet t'u nënshtrohen ndërhyrjeve politike, kur bëhet fjalë për rekrutimin e stafit. Ata duhet të jenë plotësisht të pavarur në vendosjen e politikave dhe praktikave të brendshme për menaxhimin e personelit dhe për çështje të tjera organizative.

Në shkallën prej **1 deri në 10**, sa i pavarur do të thoshit ju është autoriteti rregullator në aspektin e autonomisë organizative dhe financiare? (1 jo i pavarur, 10 plotësisht i pavarur)

Në praktikë, autoritetet rregullatore **nuk janë të pavarura** në aspektin e autonomisë financiare dhe organizative. Në këtë drejtim, ekzistojnë katër dimensione për të cilat autoritetet rregullatore mbahen përgjegjëse. Ato përfshijnë (1) burimet e financimit, (2) kontrollin e buxhetit, dhe (3) burimet njerëzore. Ndonëse ata nuk janë reciprokisht përjashtues, çdo dimension përshkruan masën deri në të cilën autoritetet rregullatore ndikohen nga jashtë. Rrjedhimisht, autoritetet rregullatore të cilat janë më të varura nga financimi i ndarë nga të ardhurat tatimore janë më pak të pavarura financiarisht. Secili autoritet i pikësnyuar ka **kontroll shumë të kufizuar buxhetor**. Ndonëse ata janë të lirë të vendosin për politikatat dhe procedurat e tyre të brendshme, autoritetet rregullatore gëzojnë pak fleksibilitet për të rekrutuar dhe mbajtur staf shumë të specializuar.

Në shkallën 1 deri në 10, sa i pavarur do të thoshit ju është autoritetit rregullator në aspektin e autonomisë financiare dhe organizative? (1 jo i pavarur dhe 10 plotësisht i pavarur)

Bazuar në cilat kritere?

Instituiconi/Organizata	0.1	0.2	0.3	0.4	0.5	0.6	0.7	0.8	0.8	0.9	1.0
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	X	X	X	X							
Autoriteti Rregullator i Hekurudhave	X	X	X	X							
Autoriteti Rregullator i Telekomit	X	X	X	X	X	X					
Autoriteti Rregullator i Energjisë	X	X	X	X	X	X	X				

KE ka qenë jashtëzakonisht kritike ndaj autoriteteve rregullatore, për atë që ato nuk janë të pavarura financiarisht dhe institucionalisht. Në Raportin e fundit të Progresit, KE ka ardhur në përfundim se disa autoritete rregullatore nuk kanë treguar asnjë përparim kur është fjala për instalimin e pavarësisë financiare dhe organizative.⁶⁸ Sipas raporteve të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), autoritetet rregullatore siç janë AKK dhe ARH kanë përjetuar shkurtime buxhetore prej **30 deri në 40 përqind** në vitin 2016. Në krahasim, ART ose ARKEP kanë marrë shkurtime buxhetore prej më pak se **10 përqind**. Ndonëse pasqyrat financiare të secilit autoritet rregullator i nënshtrohen auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), deri tani nuk janë kryer auditime apo vlerësime të jashtme të performancës. Kjo do të përfshinte ekzaminimin e programeve, të funksioneve, të operacioneve dhe/ose sistemeve të menaxhimit të autoriteteve rregullatore.

Bazuar në cilat kritere?

Kriteret për përcaktimin e nivelit të pavarësisë financiare të autoriteteve rregullatore bazohen në hulumtimin dhe raportet e vendit duke përfshirë Raportin e Progresit të Komisionit Evropian (KE) dhe Raportet e Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA). Financimi i autoriteteve rregullatore duhet të shihet nga një këndvështrim tjetër nga institucionet tipike publike, duke pasur parasysh mandatin dhe qëllimin e tyre unik dhe kushtet teknike. Disa nga çështjet kryesore që zbulojnë nivelin e pavarësisë financiare përfshijnë burimet e financimit dhe kontrollin buxhetor, e që të dyja hasen gjatë punës hulumtuese. KE e ka përsëritur në Raportin e fundit të Progresit se sa e rëndësishme është që autoritetet rregullatore të mbajnë **pavarësinë financiare**.⁶⁹ Më shumë kritika është *ngritur* kundër **sektorit të konkurrencës dhe atij të hekurudhave**. Në këtë drejtim, ZKA ka shërbyer si burim i besueshëm për të kontrolluar dhe vlerësuar nivelet e pavarësisë. Megjithatë,

më pak mund të mbliidhej në lidhje me organizimin e brendshëm dhe burimet njerëzore, duke pasur parasysh se ZKA deri tani nuk e ka audituar performancën e autoriteteve rregullatore.

Burimet e financimit

Shkalla në të cilën autoritetet rregullatore varet nga mbështetja e qeverisë është një tregues i fuqishëm i matjes së nivelit të pavarësisë institucionale nga ndërhyrja politike. Nga perspektiva e politikave, është me rëndësi të shqyrtohet nëse autoritetet rregullatore marrin fonde nga tarifrat dhe licencat kundrejt taksave ose fondeve qeveritare. Në këtë drejtim, AKK dhe ARH janë shumë më pak të pavarura në treg dhe duhet të varen nga fondet e qeverisë. ART dhe ARE financiarisht janë më të pavarura dhe të vetë-qëndrueshëm, duke pasur parasysh linjën e tyre të industrisë dhe të performancës, dhe se ato nuk varen nga financimi i qeverisë. **Burimi i buxhetit** për secilin autoritet rregullator është paraqitur në tabelën në vijim.

Agjencia Rregullatore	Financimi i Jashtëm (tarifat/taksat e mbledhura)	Qeveria
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	3,000 Euro	224,810 Euro
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	N/A	293,623 Euro
Autoriteti Rregullator i Telekomit	4,787,572 Euro	834,368 Euro
Autoriteti Rregullator i Energjisë	1,573,000 Euro	743,516 Euro

Sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), autoritetet rregullatore të fundit kanë ushtruar kontroll efektiv në menaxhimin e fondeve të jashtme në përputhje me rregulloret financiare dhe kushtet e tjera ligjore.

Burimet e financimit të autoriteteve rregullatore përbëhen nga financimi i qeverisë dhe/ose i jashtëm. Për çdo autoritet rregullator, ekziston një linjë buxhetore e pavarur e miratuar nga Kuvendi. Ndër të tjera, çdo autoritet e **ka burimin e vet të pavarur** të të ardhurave përveç Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH). Nëse autoriteti rregullator varet nga ndarjet e përgjithshme nga thesari i shtetit, “mund t’i nënshtrohet hakmarrjes politike për vendimet e saj”,⁷⁰ një kërcënim që mund të vë në shtrëngesë pavarësinë e autoritetit rregullator. Meqenëse AKK dhe ARH më shumë u nënshtrohen financimeve të ndara nga të ardhurat e përgjithshme tatimore, ato janë më pak të pavarura financiarisht. ART-ja dhe ZRRE-ja kanë burimet e tyre të pavarura të të ardhurave që rrjedhin nga të ardhurat dhe taksat e mbledhura përmes tarifave, qasjes në rrjet, licencimit, etj.

Shuma e financimit të jashtëm pasqyron fuqinë e një autoriteti rregullator - deri në ç’masë autoriteti rregullator bën **investime kapitale** për të ruajtur sektorin/tregun. Përqindja më e vogël e financimit të jashtëm gjenerohet nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK), ndërsa ARH nuk gjeneron fare financime të jashtme dhe plotësisht varet nga mbështetja e qeverisë. Në vitin 2016, AKK ka marrë **3,000 euro** për lejimin e bashkimeve dhe të blerjeve.⁷¹ Duke pasur parasysh mungesën e **qëndrueshmërisë financiare**, të gjenerimit të të ardhurave të tyre, ARH-ja dhe AKK-ja kanë bërë zero zotime financiare në investimet kapitale për të ruajtur dhe mbrojtur industrinë që ata e përfaqësojnë dhe e rregullojnë. Andaj, ata duhet t’i kthehen mbështetjes së shtetit për financim nga të ardhurat e përgjithshme tatimore. Kjo mundëson ndërhyrjen politike, mund të mos jenë aq të besueshme dhe më e rëndësishmja, nuk arrin të brendësojë kostot rregullatore në këtë sektor.⁷²

Pjesa më e madhe e **financimit të jashtëm** gjenerohet në sektorin e telekomit dhe të energjisë. Për vitin 2016, ART

kishte mbledhur **4,787,572 euro** në aspektin e të ardhurave të krijuara nga mbikëqyrja, tarifat e licencave, shfrytëzimi i frekuencave dhe dënimet. Mbi 99.99 për qind e financimit të jashtëm vjen nga licencimi komercial.⁷³ Ndërkohë, ZRRE-ja ka mbledhur **1.573.000 euro** nga taksat e mbledhura për furnizimin me ngrohje dhe energji elektrike.⁷⁴ Financimi i jashtëm në këta dy sektorë tejkalon financimin e qeverisë dhe konsiderohet si tepriçë që trajtohet si kthim në thesar. Në raste të tilla, qeveria mbështetet në paratë nga rregullatori dhe sigurisht planifikon marrjen e tyre.

Financimi i jashtëm bazuar në tarifat specifike të shërbimit si metodë bazë për financimin e autoritetit rregullator “e ka avantazhin e dërgimit të sinjaleve më të sakta të çmimeve dhe ndoshta është më mbrojtësja e pavarësisë së agjencisë.”⁷⁵ Ndonëse kjo qasje imponon kosto të larta të transaksionit dhe mund të japë më pak stabilitet në rrjedhën e të ardhurave, ajo “mund të jetë një mekanizëm shumë i dobishëm për sigurimin e fondeve për agjencitë kur kërkohet për qëllime specifike”.⁷⁶ Në vitin 2016, ART-ja ka bërë investime kapitale në vlerë prej **66,507 euro** dedikuar për avancimin dhe mirëmbajtjen e moduleve softuerike për frekuencën spektrit në komunikimet elektronike. ZRRE-ja ka bërë investime kapitale në vlerë prej **42,529 euro** të dedikuara për financimin e projekteve në sektorin e teknologjisë së informacionit (TI) dhe atë të energjisë. Megjithatë, për çdo investim kapital kërkohet miratimi paraprak i cili shpesh çon në shkurtime të investimeve kapitale.⁷⁷

Kontrolli buxhetor

Kontrolli buxhetor përkufizohet si proces menaxhues i përcaktimit të qëllimeve financiare dhe të performancës kundrejt rezultateve reale. Kontrolli buxhetor bëhet problem kur autoritetet rregullatore priren të mbështeten më shumë në të ardhurat nga thesari i shtetit, si AKK dhe ARH. Varësia

financiare u nënshtrohet ndryshimeve vjetore në mbledhjen e tatimeve, “rezultat që mund ta destabilizojë aftësinë e agjencisë për të mbajtur ritmin teknologjikisht dhe profesionalisht [që është më problematike në industrinë e telekomit dhe të energjisë ku teknologjia po ndryshon me shpejtësi].”⁷⁸ Sa u përket autoriteteve rregullatore, duke përfshirë ART-në dhe ZRRE-në,⁷⁹ të cilat janë financiarisht më të vetë-qëndrueshme, kompetenca të kufizuara diskrecionale mbi shpenzimet publike bëhen problem.

Buxhetet e autoriteteve rregullatore i nënshtrohen miratimit nga dega ekzekutive, sapo ato të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF). Për secilin autoritet rregullator, ekziston procesi që i nënshtrohet miratimit administrativ dhe/ose legjislativ të kërkuar para se të autorizohen shpenzimet. Megjithatë, në praktikë, ky proces nuk konsiderohet efektiv. Ministria nuk kryen rishikim të plotë të buxhetit dhe as nuk komunikon mjaftueshëm me autoritetet rregullatore për konsultim.⁸⁰ Në çdo rast, kërkesat dhe komentet e autoriteteve rregullatore rrallëherë merren në konsideratë.⁸¹ Ministria nuk angazhohet në diskutime të gjera me autoritetet rregullatore mbi prioritetet buxhetore dhe kostot.

Kur miratohet Ligji për Buxhetin, parashikohet që shumica e paguar tek autoritetet rregullatore do të duhej të lejonte të mbështesë aktivitetet e veta dhe të investojë në trajnime dhe ekspertizë, financojë agjencitë e konsumatorëve, etj. Megjithatë, këto plane janë ndërprerë nga Ministria e Financave, e cila kohët e fundit ka vënë kufizime të rrepta në shpenzimet publike si pjesë e përpjekjeve të saj për të vënë në zbatim disiplinën fiskale. Kjo është arsyeja se pse Ministria i trajton tarifat rregullatore të mbledhura nga furnizuesit dhe konsumatorët si “taksë të fshehur”, për të mos qenë ndryshe nga të ardhurat e qeverisë. Dhe për çdo financim nga qeveria, ka zvogëlime nga shumatat të cilat fillimisht janë propozuar nga autoritetet rregullatore.

Zyrtarët nga autoritetet rregullatore ankohen se mungesa e resurseve ka ndikuar negativisht në cilësinë e punës. Ndonëse, opinionet e tyre në fakt janë subjektive, ato janë të përhapura gjerësisht në sektorin e shoqërisë civile të cilët janë të njohur me autoritetet rregullatore. Shkurtimeve buxhetore deri në shkallë shumë serioze e dëmtojnë shumë efektivitetin e sistemit rregullator. Ndonëse në Kosovë nuk ka dëshmi se motivi i Ministrisë për shkurtime të buxhetit nuk është tjetër fare përveç atij fiskal, është shumë e lehtë të shihet se si mund të përdoren aranzhimet buxhetore për ta vënë në rrezik jo vetëm efektivitetin, por edhe pavarësinë e agjencive rregullatore. Në rastin e ZRRE-së, shkurtimeve buxhetore kanë çuar në vonesa sa u përket pagimit të pagave zyrtarëve të porsa - angazhuar. Kjo qasje ndaj shkurtimeve/kufizimeve të buxhetit ka shkaktuar shqetësime në menaxhment, për shkak të kompensimit jo të duhur dhe frustrim lidhur me atë se duhet ta kryejnë punën e tyre me resurse joadekuate në dispozicion të tyre.⁸²

Një burim i besueshëm informacioni që shpjegon se deri në ç'masë autoritetet rregullatore e ushtrojnë kontrollin buxhetor është Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA). ZKA kryen auditime të pavarura të autoriteteve rregullatore, ashtu siç bën edhe me institucionet e tjera publike dhe i raporton Kuvendit të Kosovës. Raportet e auditimit u ofrojnë anëtarëve të Kuvendit informata objektive për t'u ndihmuar atyre që t'i shqyrtojnë aktivitetet e qeverisë dhe ta mbajnë atë përgjegjëse. Derisa ZKA në raportet e fundit të auditimit të katër autoriteteve rregullatore dha një "opinion të pakualifikuar", duke treguar se pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kornizën e raportimit financiar, ekzistojnë disa shqetësime lidhur me shkurtimeve buxhetore, ku ata i ilustrojnë mjetet e qeverisë për të ndërhyrë në pavarësinë e autoriteteve rregullatore.

Pavarësia financiare e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

(AKK) dhe Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH) u janë nënshtruar ndërhyrjeve më të mëdha politike. Zvogëlimi i mbështetjes buxhetore për këto autoritete rregullatore e justifikon një cenueshmëri të tillë! AKK ka përjetuar zvogëlim të buxhetit të propozuar nga 266,350 euro në vitin 2015 në **224,810 euro** në vitin 2016. Buxheti i miratuar nga Kuvendi ka qenë 181,178 euro. Shuma e shpenzuar ishte **179,476 euro** në vitin 2016 krahasuar me 125,979 euro në vitin 2015.⁸³ ARH gjithashtu ka përjetuar zvogëlim të buxhetit të propozuar nga 325,421 euro në vitin 2015 në **293,623 euro** në vitin 2016. Buxheti i miratuar nga Kuvendi ka qenë 203,349 euro. Shuma e shpenzuar në vitin 2016 ishte **201,251 euro** krahasuar me 237,903 euro në vitin 2015.⁸⁴ Shkurtimet buxhetore janë gjithashtu produkt i menaxhimit të dobët. Për shembull, buxheti për ARH-në është zvogëluar me 42,626 euro për shkak të vonesave në emërimin të anëtarëve të bordit.

Pavarësia financiare e ART-së dhe ZRRE-së është më pak subjekt i ndërhyrjes së qeverisë. ART ka përjetuar një rritje të lehtë të buxhetit të propozuar nga 756,301 euro në vitin 2015 në **796,568 euro** (ndonëse në vitet paraprake e ka tejkaluar pak 1 milion euro). Buxheti i miratuar nga Kuvendi ka qenë 777,885 Euro. Shuma e shpenzuar në vitin 2016 ishte 757,975 euro krahasuar me 617,944 euro në vitin 2015.⁸⁵ Megjithatë, ka pasur zvogëlim të buxhetit për investimet kapitale për 43,493 euro për shkak të dështimit të Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP) në prokurimin e projekteve investive. ARE ka përjetuar rritje të lehtë të buxhetit të propozuar nga 682,206 euro në vitin 2015 në **743,516 euro** në vitin 2016. Buxheti i miratuar nga Kuvendi ka qenë 690,938 euro. Shuma e shpenzuar në vitin 2016 ishte 678,711 euro krahasuar me 544,150 euro në vitin 2015.⁸⁶

Burimet njerëzore

Në përgjithësi, autoritetet rregullatore në masë të madhe i nënshtrohen njëfarë ndërhyrje politike, veçanërisht kur është fjala për politikat e personelit si rekrutimi, gradimi dhe pagat, të gjitha këto në shumicën e rasteve rregullohen sipas Ligjit për Shërbimin Civil. Kushtet teknike në autoritetet rregullatore në lidhje me rekrutimin e personelit dhe prokurimin e mallrave dhe shërbimeve komplekse e bëjnë të vështirë që ata ta mbajnë hapin me tregun që ata rregullojnë. Ndryshimi i Ligjit për Prokurim Publik në mars 2016 i jep autoritet qeverisë që të kryejë procedurat e prokurimit në emër të agjencive që kanë më pak se 50 anëtarë të stafit,⁸⁷ gjë që ndodh me gati të gjitha autoritetet rregullatore. Ky ligj ka krijuar vonesa të paarsyeshme për autoritetet rregullatore në prokurimin e mallrave dhe të shërbimeve.⁸⁸

Me përjashtim të Zyrës së Rregullatorit për Energji, rregullatorët e tjerë punësojnë shërbyes civilë. Pagat e anëtarëve të bordit rregullohen nga Kuvendi deri në miratimin e Ligjit për Zyrtarët e Lartë Publikë. Në përgjithësi, legjislacioni nuk është mjaftueshëm fleksibil për të lejuar që autoritetet rregullatore të rekrutojnë, mbajnë dhe gradojnë personelin me nivelin e nevojshëm të njohurive, aftësive dhe të përvojës për ta kryer në mënyrë efektive punën e specializuar në sektorët përkatës. Një pjesë e problemit është shkalla relativisht e ulët e rrogave e rregulluar për shërbyesit civilë, që është një faktor demotivues për stafin potencial për t'iu bashkuar organizatave.

Për kapacitetet njerëzore që çdo autoritet rregullator i ka po ashtu kërkohet një analizë sasiore - e numrit të njerëzve të punësuar dhe shkathtësive/njohurive që ata trashëgojnë siç paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

AKK - aktualisht ka **17 punonjës**, prej të cilëve 11 janë shërbyes civilë (65 përqind) dhe 5 të emëruar politik (45 përqind). Pagat e shërbyesve civilë rregullohen sipas Ligjit për Shërbimin Civil me koeficiente të barabartë me ata në ekzekutiv. Pagat e anëtarëve të komisionit caktohen nga Kuvendi me propozim të Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës.

ARH - aktualisht ka **17 punonjës**, prej të cilëve 16 janë shërbyes civilë (94 përqind) dhe 1 staf administrativ (6 përqind). Pagat e shërbyesve civilë rregullohen sipas Ligjit për Shërbimin Civil me koeficiente të barabartë me a tanë ekzekutiv. Pagat e anëtarëve të bordit caktohen nga Kuvendi me propozim të Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës.

ART - aktualisht ka **37 punonjës**, prej të cilëve 32 janë shërbyes civilë (86 përqind) dhe 5 të emëruar politikë (14 përqind). Pagat e shërbyesve civilë rregullohen sipas Ligjit për Shërbimin Civil me koeficiente të ndryshëm nga ata të shërbyesve civilë në ekzekutiv. Këta koeficientë caktohen në bazë të përshkrimit të punës dhe të detyrave dhe miratohen nga bordi. Pagat e anëtarëve të bordit caktohen nga Kuvendi me propozim të Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës.

ZRRE - aktualisht ka **33 punonjës** prej të cilëve asnjë nuk është shërbyes civilë dhe 5 të emëruar politikë. Pagat dhe kompensimet e stafit rregullohen nga bordi ekuivalent i nivelit të pagës në sektorin që e rregullon. Pagat e anëtarëve të bordit caktohen nga Kuvendi deri në përshatjen e legjislacionit për pagat e zyrtarëve të lartë publikë.

Të mos jesh në gjendje të rekrutosh dhe të mbash stafin e kualifikuar dhe të përdorësh pajisjet e kërkuara ka të ngjarë të ketë “efekte negative në cilësinë e mbrojtjes së konsumatorit dhe në efektshmërinë e rregullimit në përgjithësi”.⁸⁹ Kjo është veçanërisht e rëndësishme në industrinë ku ata duhet të garojnë për personelin dhe resurset e të njëjtit treg.

Meqenëse profesionet e ndërlidhur me sektorët rregullatorë janë relativisht të rinj në vend dhe ende po paraqiten, autoritetet rregullatore kanë tendencë të plotësohen me personel më të ri. Për shumë kë, kjo mund të konsiderohet si pengesë, duke marrë parasysh tendencën e ekspertëve të rinj që t’u bashkohen kompanive të rregulluara për paga më të mira dhe mundësi karriere siç është rasti me ARKEP-in.⁹⁰ Në këtë drejtim, duke investuar në aftësimin e personelit më të ri dhe pastaj humbja e vlerës së një investimi të tillë është humbje e kapitalit njerëzor, e janë kompanitë e rregulluara ato të cilat mund të nxjerrin përfitime. Kjo zakonisht ndodh kur pagat nuk janë konkurruese, siç është rasti në ARKEP ku stafi profesional paguhet si shërbyes civilë. Në veçanti, duke iu bashkuar kompanive të rregulluara, kjo imponon një çështje etike. Në përgjithësi punonjësit që lëvizin nga autoritetet rregullatore tek kompanitë e rregulluara mund të sjellin njohuri të brendshme dhe informacion të fshehtë që mund të rrezikojnë integritetin e sistemeve rregullatore.

Përveç kësaj, zakonisht mandatet e stafit të lartë janë fikse me rrimërim të kufizuar dhe i nënshtrohen kushteve të përcaktuara, gjë që ndihmon në ruajtjen e sjelljes së paanshme. Sa i përket burimeve njerëzore, Qeveria mban disa përgjegjësi të vogla për ato organe të pavarura të plotësuara me shërbyes civilë.⁹¹ Dy raste mund të shpjegojnë se sa kufizuese janë rregullat e shërbimit publik për autoritetet rregullatore. Sistemi i shërbimit civil më shumë shtysë e ka sasinë se sa cilësinë – se sa mbikëqyren personat

sesa nga shkalla e trajnimit dhe ekspertizës që ata kanë. Kjo ndryshon sa u përket autoriteteve rregullatore. Ato anojnë më shumë se njësitë qeveritare të linjës dhe lidhjet ndërmjet kompensimit dhe numrit të njerëzve të mbikëqyrur janë thjesht kundër-produktive. Përveç kësaj, personeli i lartë në autoritetet rregullatore tundohet të shkojë të punojë në kompanitë e rregulluara ku kompensimi është më tërheqës.

Rekomandime

Pavarësia e autoriteteve rregullatore është shumë e rëndësishme për forcimin e demokracisë së vendit. Mbrojtja e autoriteteve rregullatore duhet të paraqesë një shenjë e qartë të zotimit të qeverisë ndaj standardeve demokratike dhe evropiane.

Lista e rekomandimeve është e përpiluar në përputhje me gjetjet e hulumtimit:

- Emërimi i anëtarëve të bordit të autoriteteve rregullatore duhet të rregullohet në mënyrë kolektive dhe asnjë post nuk duhet të mbetet i paplotësuar deri në emërimin e anëtarit të ri.
- Legjislatura duhet të ndryshojë Rregulloren e Punës për emërimin e anëtarëve të bordit të cilët nuk kanë dështuar në përpjekjen e parë për t'u votuar dhe aprovuar nga deputetët e Kuvendit.
- Duhet të krijohen mekanizma më të avancuar të kontrollit/verifikimit për të siguruar që anëtarët e bordit të autoriteteve rregullatore të mos jenë në konflikt interesi ose të mund të përfshihen në gabime të tjera që do të mund ta dëmtonin integritetin institucional.
- Gjyqësori duhet të rrisë kapacitetin e vet dhe të bëhet më efektiv në zgjidhjen e kontesteve për çështje të caktuara ose çështje që kanë të bëjnë me autoritetet rregullatore.
- Autoritetet rregullatore duhet të përmirësojnë rolin e tyre sa i përket këshillimit të institucioneve përkatëse për të marrë vendime dhe politika më të mira kur është fjala për rregullimin e tregjeve ose të industrive.
- Legjislatura duhet të krijojë mekanizma të llogaridhënies për sanksionimin e autoriteteve rregullatore për performancë të dobët (p.sh. shkarkimin e anëtarëve të bordit).

- Legjislatura duhet të përcaktojë kriteret për vlerësimin e raporteve të agjencive të pavarura, duke zhvilluar sistemin e përcjelljes së rekomandimeve, për të përcjellë rekomandimet e raportit për t'i mbajtur autoritetet rregullatore përgjegjëse për performancën e tyre.
- Qeveria t'i lejojë autoritetet rregullatore që të shpenzojnë për investime kapitale me qëllim të zhvillimit të sektorëve të industrisë që ato i rregullojnë dhe të frymëzojnë qëndrueshmërinë organizative.
- Qeveria duhet të përmbahet nga shkaktimi i shkurtimeve të buxhetit dhe në vend të kësaj duhet të ketë parasysh prioritetet dhe komentet nga autoritetet rregullatore sa u përket konsultimeve buxhetore.
- Ligjet për shërbimin civil dhe prokurimet publike duhet të ndryshojë për të pasqyruar një proces më efikas dhe më efektiv të rekrutimit të stafit dhe të prokurimit të mallrave dhe të shërbimeve në dobi të autoriteteve rregullatore.

Shtojca 1: Pyetësor mbi pavarësinë e rregullatorëve

Si pjesë e hulumtimit mbi pavarësinë e rregullatorëve në Kosovë, i mbështetur nga **Fondacioni Heinrich Böll (HBF)**, ky pyetësor është përdorur për të intervistuar shefa/drejtorë të institucioneve të pikë-synuara, duke shpresuar se do të sigurojmë të dhëna se si dhe deri në çfarë shkalle ata janë të pavarur.

Cekni postin tuaj në agjencinë rregullatore?

Shef/Drejtor

Nëse tjetër, ju lutem cekni: _____ -

Statusi formal, misioni dhe përgjegjësia

1) Cilat janë objektivat rregullatore të autoritetit rregullatorë (të cekura në mënyrë eksplicite në legjislacion ose në deklaratën e misionit)

2) A ceket pavarësia e autoritetit rregullatorë në mënyrë formale qoftë në legjislacion ose në statutin e autoritetit rregullatorë? (shënoni përgjigjen e saktë me X)

» Deri në çfarë shkalle është i pavarur në praktikë?

3) Kush është përgjegjës për vendimet e autoritetit rregullatorë?

» Sa aktivë janë ata që janë përgjegjës?

4) Cila është përvoja profesionale e kreut të tashëm të agjencisë/anëtarëve të bordit?

» Sa profesionalë janë anëtarët e bordit?

(I) Emërimet & mandati

Në shkallën prej 1 deri në 10, sa i pavarur do të thoshit ju është bordi i autoritetit rregullator përmes emërimit dhe statusit formal? (1 jo i pavarur, 10 plotësisht i pavarur)

- » Mbi cilat kriteret e bazoni këtë gjykim?
- 5) Cili është mandati i anëtarëve të bordit të agjencisë?
 - » A ka pasur shkelje të këtyre mandateve?
- 6) Kush i emëron anëtarët e bordit dhe shefin e agjencisë?
 - » A ka pasur shkelje sa u përket emërimeve në të kaluarën?
- 7) Cilat janë dispozitat në lidhje me shkarkimin e anëtarëve të bordit të autoritetit?
 - » A ka pasur ndonjë shkarkim në të kaluarën?
- 8) A mund të mbajnë anëtarët e bordit të autoritetit poste të tjera në qeveri?
 - » A ka pasur ndonjë rast në të kaluarën?
- 9) A ka mundur që shefi i agjencisë të ketë mbajtur ndonjë pozitë në industrinë (publike ose private)/asociacion industrial *në vitet që i kanë paraprirë* emërimit të tij/saj?
 - » A ka pasur ndonjë rast në të kaluarën?
- 10) A është i përtërishëm emërimi?
 - » A ka pasur shkelje sa u përket rasteve të emërimeve në të kaluarën?
- 11) A është pavarësia një kusht formal për emërim?
 - » Sa i pavarur është secili anëtar i bordit në praktikë?

(II) Vendim-marrja

Në shkallën prej 1 deri në 10, sa i pavarur do të thoshit ju është autoritetit rregullator në vendim-marrjen reale? (1 jo i pavarur, 10 plotësisht i pavarur)

» Mbi cilat kritere e bazoni këtë gjykim?

12) Cilat kompetenca i ushtron autoriteti rregullator në këto detyra në lidhje me *sektorin*?

→ Aprovimi ose përcaktimi i tarifave të kompanive monopoliste

→ Qasja në rrjet

→ Licencimi dhe modifikimi i licencave

→ Vendosja e rregullave në lidhje me kushtet e ofrimit të shërbimeve (në kuadër të kufizimeve të legjislacionit ekzistues)

→ Zgjidhja e kontesteve (ndërmjet kompanive dhe mes kompanive dhe konsumatorëve të tyre)

» Cila është përvoja juaj në praktikë?

13) Cila nga detyrat e mëposhtme i kryen autoriteti rregullator?

a) jep këshilla qeverisë përkitazi me politikat

b) ofrimi i informatave konsumatorëve për tregun (transparenca)

c) pjesëmarrja në bashkëpunim ndërkombëtar dhe bërje të politikave

d) monitorimi i sjelljes dhe performancës së tregut

» Cila është përvoja juaj në praktikë?

14) Cilat janë obligimet formale të llogaridhënies së autoritetit rregullator ndaj qeverisë?

- a) asnjë
 - b) paraqitja e raportit vjetor vetëm për qëllime informimi
 - c) paraqitja e raportit vjetor për aprovim
 - d) agjencia është plotësisht llogaridhënëse
- » Cila është përvoja juaj në praktikë?
- 15) Cilat janë obligimet formale të llogaridhënies së autoritetit rregullator ndaj legjislaturës?

- a) asnjë
 - b) paraqitja e raportit vjetor vetëm për qëllime informimi
 - c) paraqitja e raportit vjetor për aprovim
 - d) agjencia është plotësisht llogaridhënëse
- » Cila është përvoja juaj në praktikë?

(III) Institucioni/Organizata

Në shkallën prej 1 deri në 10, sa i pavarur do të thoshit ju është autoriteti rregullator në aspektin e autonomisë organizative dhe financiare? (1 jo i pavarur, 10 plotësisht i pavarur)

- » Mbi cilat kritere e bazoni këtë gjykim?
- 16) Cili është burimi i buxhetit të autoritetit rregullator?
 - 17) Kur është ndarë buxheti, kush e kontrollon buxhetin?
 - 18) Kush është përgjegjës për politikat e personelit të autoritetit rregullator (rekrutimi, gradimi, pagat)?

Lista e publikimeve

Zgjedhjet & Partitë Politike

- #1 Instituti D4D. Shtator 2011 Zbërthimi i trendeve zgjedhore 2000-2010.
- #2 Instituti D4D. Mars 2012. Reformë sa për adet: Si të rikthejmë besimin në zgjedhje?
- #3 Malazogu, Leon, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Nëntor 2012. Auditim i listës së votuesve të Kaçanikut: Mostër për Kosovën
- #4 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shkurt 2013. Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme – Analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik?
- #5 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Interpretimi i besimit – Përceptimi i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes.
- #6 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Deforma zgjedhore – Dy vite pas, reforma në pikën zero
- #7 Leon Malazogu dhe Brenna Gautam; Me kontribut nga Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 26 nëntor 2014. Busolla ideologjike e Kosovës – Hartë e orientimit të partive politike
- #8 Dardan Berisha me kontributin e Driton Qeriqi, Mjellma Hapçiu-Alijaj dhe Rina Vokshi, korrik 2015. Vendosja e drejtësisë në zgjedhje
- #9 Leon Malazogu me kontributin e Ngadhnjim Halilaj dhe Rezarta Delibashzade, korrik 2015 Trendet zgjedhore 2000-2014-Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit
- #10 Thomas Atherton, Driton Qeriqi dhe Rina Vokshi, Shkurt 2016 Doracak për barazi gjinore në procesin zgjedhor

Rekomandimet e Forumit Reforma

- #1 Instituti D4D. 29 nëntor 2011. Struktura e KQZ-së
- #2 Hartuar nga Instituti D4D. 17 janar 2011. Sistemi zgjedhor
- #3 Hartuar nga Instituti D4D. 29 nëntor 2011. Riparimi i listës së votuesve
- #5 Hartuar nga Instituti D4D. 12 dhjetor 2011. Rekomandimet për Zgjedhjen e Presidentit të Kosovës
- #6 Mbështetur nga: D4D, KIPRED, INPO, KMDLNJ, INDEP, DT, KHK, QPA, dhe NOMP. Për reformë të mirëfilltë zgjedhore

Marrëdhëniet ndëretnike

- #1 Malazogu, Leon dhe Vladimir Todorić. Nëntor 2011. Dialogu Beograd – Prishtinë: Nevojitet transformim i interesit vetanak. PER-K/D4D Institute and NPC-Belgrade
- #2&3 Malazogu, Leon, Viktor Popović dhe Shpend Emini. Mars 2012. Perspektiva e një të riu serb në Kosovë/Jeta urbane në vendbanime me shumicë serbe në Kosovë. PER-K/D4D.
- #4 Malazogu, Leon dhe Florian Bieber. Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen. PER-K/Instituti D4D
- #5 Malazogu, Leon dhe Alex Grigorev. Shtator 2012. Nga paqartësia kreative në proces konstruktiv – Si ti qasemi veriut të Kosovës? PER-K/Instituti D4D
- #6 Ejdus, Filip, Leon Malazogu dhe Milan Nic. Tetor 2013. Zgjedhjet komunale në veri të Kosovës: Drejt një ekuilibri të ri? Publikuar bashku CEPI, BCSP dhe D4D. (Vetëm në gjuhën angleze)
- #7 Mjellma Hapçiu-Alijaj dhe Ajete Kërçeli. Me kontribut nga: Shpend Emini, Rezarta Delibashzade dhe Ferid Murseli. Tetor 2016. Gratë e fuqizuara: çelës për transformimin e komuniteteve

Interesi Publik

- #1 Sejdiu, Dardan dhe Kastriot Jahaj. Janar 2013. ‘Taksa’ e fshehur: pse kosovarët paguajnë më shumë?
- #2 Gashi, Drilon and Shoghi Emerson. Maj 2013. Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë
- #3 Sutaj, Visar and Leon Malazogu. Janar 2013. Roli i shoqatave me anëtarësi në formësimin e vendimmarrjes në shërbim të interesit publik
- #4 Miftari, Naser. Shtator 2013. Sfida e konsolidimit – Fuqizimi i pavarësisë së institucioneve të medias në Kosovë
- #5 Ardiana Gashi dhe Artane Rizvanolli; Me kontribut nga Natalya Wallin, Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 25 shkurt 2015. Sa kushton patriarkati?
- #6 Rezarta Delibashzade, Laura Flemming, Ramadan Klisurica, Agon Maliqi dhe Rina Abazi. 11 Nëntor 2015 Rëndësia e grupeve të interesit: Praktikant, rastet studimore dhe mësimet e nxjerra
- #7 Dukagjin Pupovci dhe Gersi Gashi. Nëntor, 2015 Reformimi i Universiteti të Prishtinës – mission i mundur?
- #8 Leon Malzogu dhe Bernard Nikaj; Me kontribut nga Gulliver Brady. Nëntor, 2016. Nxitje për llogaridhënie dhe performancë më të mirë në arsimin e lartë
- #9 Jehona Serhati, me kontribut redaktues nga Abby Riley. Janar, 2017. Stimujt për reformë: Rritja e mundësive për nxënësit/et dhe të diplomuarit/at e AAP-së në tregun e punës
- #10 Isuf Zejna. Korrik 2017. Zhvillimi i turizmit përmes politikave dhe legjislacionit efikas.

Memorandume Reaguese

- #1 Instituti D4D. Nëntor 2012. Memorandumi reagues Nr. 1 – Reagimi i tepruar i policisë
- #2 Instituti D4D. Dhjetor 2012. Memorandumi reagues Nr. 2 – Modeli i dy Gjermanive
- #3 Instituti D4D. 12 Korrik 2013. Memorandumi reagues Nr. 3 – Kriteria të qarta për komuna të reja
- #4 Instituti D4D & Qëndrim Gashi. Janar 2013. Memorandum reagues nr. 4 – Universiteti i Prishtinës në rreth vicioz
- #5 Instituti D4D dhe Kushtrim Palushi. Janar 2013. Memorandum reagues nr. 5 – Reforma zgjedhore
- #6 Instituti D4D. Nëntor 2016. Memorandum reagues nr.6 – Reforma zgjedhore

Indikatorët & skenaret

- #1 Instituti D4D. Nëntor 2010. Para dhe Pas-Performanca e bazuar në indikatorë: Vlerësimi vjetor 2010
- #2 Instituti D4D. Shteti në Pasqyrë: Indikatorët e Bazuar në Performancë
- #3 Malazogu, Leon. Nëntor 2013. As për emër nuk janë pajtuar: Shtyrja e problemit nuk do të afrojë palët në lidhje me asociacionin/bashkësinë. (Vetëm në gjuhën angleze)
- #4 Malazogu, Leon. Janar 2014. Parashikime dhe skenare: Kosova dhe Bota në 2014

Publikime të tjera

- #1 Seritë e editorialeve dhe rekomandimeve mund gjithashtu të gjinden në ueb-faqen tone.

Shënime përfundimtare

- 1 OECD. Raport Vlerësues për Kosovën 2014. SIGMA. 2014, f. 17.
- 2 Abazi, Dardan & Burim Ejupi. Funksionalizimi i Agjencive të Pavarura. INDEF. 2016, f. 3.
- 3 Qeveria. Dialogu i Nivelit të Lartë Kosovë – BE mbi Prioritetet Kyçe – Agjenda e Reformës Evropiane (ARE). 2016, f. 4.
- 4 Qeveria. Programi i Reformës Ekonomike në Kosovë (PRE). 2017, f. 76.
- 5 OECD. Raporti Bazë i Matjes: Kosova. SIGMA. prill 2015, f. 64.
- 6 Qeveria. Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 (2017-2021), f. 23.
- 7 Qeveria. Qeveria. Rregullorja nr. 06/2015 për Regjistrin Qendror të Llojeve të Lejeve dhe Licencave. Neni 1-11. prill 2015.
- 8 OECD. Raporti Bazë i Matjes: Kosova. SIGMA. prill 2015, f. 67.
- 9 OECD. Raporti Bazë i Matjes: Kosova. SIGMA. prill 2015, f. 67.
- 10 Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 119. qershor 2008, f. 44.
- 11 OECD. Raport Vlerësues për Kosovën 2014. SIGMA. 2014, f. 16.
- 12 MAP. Rishikimi i Institucioneve dhe i Agjencive të Kuvendit dhe të Organeve Qendrore të Qeverisë. dhjetor 2016, f. 6.
- 13 Gazeta Zyrtare. Ligji nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Neni 1. nëntor 2010, f. 1.
- 14 Gazeta Zyrtare. Ligji nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Neni 1. nëntor 2010, f. 1.
- 15 Gazeta Zyrtare. Ligji nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Neni 10. nëntor 2010, f. 5.
- 16 Gazeta Zyrtare. Neni 1-2. dhjetor 2011, f. 1.
- 17 Gazeta Zyrtare. Ligji nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike s. Neni 1. nëntor 2012, f. 1.
- 18 Gazeta Zyrtare. Ligji nr. 05/L-081 për Energjinë. Neni 1. korrik 2016, f. 1.
- 19 Online/Skan i faqes së internetit: <https://ak.rks-gov.net/> [e qasur më 20 korrik 2017].
- 20 Gazeta Zyrtare. Ligji nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Neni 24. nëntor 2010, f. 13.
- 21 Gazeta Zyrtare. Ligji nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës. Neni 1-2.

dhjetor 2011, f. 1.

22Gazeta Zyrtare. Ligji nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës. Neni 5. dhjetor 2011, f. 5.

23Gazeta Zyrtare. Ligji nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës. Neni 9. dhjetor 2011, f. 6.

24Online/Skan i faqes së internetit: <http://www.arkep-rks.org/> [e qasur më 20 korrik 2017]

25Gazeta Zyrtare. Ligji nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike. Neni 4. nëntor 2012, f. 2.

26Online/Skan i faqes së internetit: <http://www.ero-ks.org/> [e qasur më 20 korrik 2017]

27Kuvendi. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Kuvendit, Qeverisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Neni 1. gusht 2016, f. 1.

28Kuvendi. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Kuvendit, Qeverisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Neni 2. gusht 2016, f. 2.

29Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Nëntor 2016, f. 4.

30Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Nëntor 2016, f. 59.

31Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Nëntor 2016, f. 60.

32Gashi, Kreshnik. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Intervistë. 25 korrik 2017.

33Prestreshi, Valon. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK). Intervistë. 21 korrik 2017.

34Abazi, Dardan & Burim Ejupi. Funksionalizimi i Agjencive të Pavarura. INDEF. 2016, f. 19.

35Demi, Agron & Visar Rushiti. Instituti GAP. Intervistë. 13 korrik 2017.

36Pepaj, Petrit. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE). Intervistë. 17 korrik 2017.

37Demi, Agron & Visar Rushiti. Instituti GAP. Intervistë. 13 korrik 2017.

38Zhubi, Driton. Lens. Intervistë. 25 korrik 2017.

39Abazi, Dardan & Burim Ejupi. Funksionalizimi i Agjencive të Pavarura. INDEF. 2016, f. 3.

40Prestreshi, Valon. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK). Intervistë.

21 korrik 2017.

41Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Nëntor 2016, f. 40.

42Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Nëntor 2016, f. 59.

43Online/Skan i faqes së internetit: <http://www.arkep-rks.org/> [e qasur më 25 korrik 2017]

44Abazi, Dardan & Burim Ejupi. Funksionalizimi i Agjencive të Pavarura. INDEF. 2016, f. 4.

45Kallxo.com. Rregullatori i Konkurrencës në Menaxhim të Ç'rregullt. August 5, 2013.

46Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Nëntor 2016, f. 58-59.

47Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Nëntor 2016, f. 58.

48Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Nëntor 2016, f. 61.

49Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Nëntor 2016, f. 60.

50Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Nëntor 2016, f. 60.

51Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Nëntor 2016, f. 60.

52Pepaj, Petrit. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE). Intervistë. 17 korrik 2017.

53Rexha, Albana. Llogaridhënia e Agjencive të Pavarura në Kosovë: Vështrim mbi Perspektivat e Tanishme dhe Sfidat Kryesore. GLPS. 2017, f. 20.

54Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Nëntor 2016, f. 7.

55Nunes, R., Sofia B. Nuries, Guilhermina Rego. A New Governance Model for Independent Regulatory Agencies. SRF. January 19, 2015, f. 7.

56Abazi, Dardan & Burim Ejupi. Funksionalizimi i Agjencive të Pavarura. INDEF. 2016, f. 3.

57OECD. Raport Vlerësues për Kosovën 2014. SIGMA. 2014, f. 17.

58OECD. Raporti Bazë i Matjes: Kosova. SIGMA. prill 2015, f. 58.

- 59Abazi, Dardan & Burim Ejupi. Funksionalizimi i Agjencive të Pavarura. INDEF. 2016, f. 15.
- 60Qorri, Shkelzen. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH). Intervistë. 26 korrik 2017.
- 61Kuvendi. Mbledhja 97/2017. Procesverbali i mbledhjes. 2 maj 2017.
- 62Abazi, Dardan & Burim Ejupi. Funksionalizimi i Agjencive të Pavarura. INDEF. 2016, f. 4.
- 63Rexha, Albana. Llogaridhënia e Agjencive të Pavarura në Kosovë: Vështrim mbi Perspektivat e Tanishme dhe Sfidat Kryesore. GLPS. 2017, f. 9.
- 64Online/Skan i faqes së internetit: <https://ak.rks-gov.net/> [e qasur më 15 korrik 2017].
- 65Online/Skan i faqes së internetit: <http://www.arh-ks.org/> [e qasur më 15 korrik 2017]
- 66Online/ Skan i faqes së internetit: <http://www.arkep-rks.org/> [A e qasur më 15 korrik 2017]
- 67Online/ Skan i faqes së internetit: <http://www.ero-ks.org/> [e qasur më 15 korrik 2017]
- 68Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Nëntor 2016, f. 61.
- 69Komisioni Evropian. Dokument i Punës i Stafit të Komisionit. Raporti i Progresit. Nëntor 2016, f. 59.
- 70Brown, Ashley C. The Funding of Independent Regulatory Agencies. Harvard University. 2006, f. 4-5.
- 71Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti i auditimit për deklaratat vjetore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës 2016. Qershor 2017, f. 15.
- 72Brown, Ashley C. The Funding of Independent Regulatory Agencies. Harvard University. 2006, f. 1.
- 73Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti i auditimit për deklaratat vjetore të ARKEP. Qershor 2017, f. 15.
- 74Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti i auditimit për deklaratat vjetore të Zyrës Rregullatore për Energjinë. Qershor 2017, f. 13.
- 75Brown, Ashley C. The Funding of Independent Regulatory Agencies. Harvard University. 2006, f. 1.
- 76Brown, Ashley C. The Funding of Independent Regulatory Agencies. Harvard University. 2006, f. 1.

- 77Pepaj, Petrit. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE). Intervistë. 17 korrik 2017.
- 78Brown, Ashley C. The Funding of Independent Regulatory Agencies. Harvard University. 2006, f. 4-5.
- 79Pepaj, Petrit. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE). Intervistë. 17 korrik 2017.
- 80Pepaj, Petrit. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE). Intervistë. 17 korrik 2017.
- 81Prestreshi, Valon. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. Fokus grupi. 19 shtator 2017.
- 82Pepaj, Petrit. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE). Intervistë. 17 korrik 2017.
- 83Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti i auditimit për deklaratat vjetore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës 2016. Qershor 2017, f. 15.
- 84Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti i auditimit për deklaratat vjetore të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave. Qershor 2017, f. 15.
- 85Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti i auditimit për deklaratat vjetore të ARKEP. Qershor 2017, f. 14.
- 86Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti i auditimit për deklaratat vjetore të Zyrës Rregullatore për Energjinë. Qershor 2017, f. 13.
- 87Gazeta Zyrtare. Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik. Neni 1. Mars 2016, f. 1.
- 88Gashi, Kreshnik. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Fokus grupi. 18 shtator 2017.
- 89Brown, Ashley C. The Funding of Independent Regulatory Agencies. Harvard University. 2006, f. 1-2.
- 90Gashi, Kreshnik. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Intervistë. 25 korrik 2017.
- 91OECD. Raport Vlerësues për Kosovën 2014. SIGMA. 2014, f. 17.

Sa të pavarura janë autoritetet rregullatore në Kosovë?

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

658(496.51)(048)

Sa të pavarura janë autoritetet rregullatore në Kosovë? : një vështrim më nga afër i autoriteteve rregullatore në konkurrencë, hekurudha, telekom dhe energji / përgatitur Visar Sutaj. – Prishtinë : Demokraci për zhvillim, 2017. – 67 f. ; 21 cm. - (Seria : Interesi publik ; 11)

1.Sutaj, Visar

ISBN 978-9951-608-59-6

Demokraci për Zhvillim (D4D) është një institut hulumtues i themeluar në vitin 2010 me besimin se demokracia është parakusht për zhvillim. Misioni i D4D-së është të ndikojë në proceset e zhvillimit të politikave publike në mënyrë që të përshpejtojë zhvillimin socio-ekonomik të vendit, përmirësimin e qeverisjes dhe për të përforcuar kulturën demokratike në Kosovë.

Vizioni i D4D-së është të promovojë një shoqëri aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë në hapësirën publike dhe e përdor atë për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e burimeve të cilat janë efëiente, të shpejta, afat-gjate dhe që sjellin zhvillim të paanshëm.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org.

 **HEINRICH BÖLL STIFTUNG**
SERBIA, MONTENEGRO, KOSOVO

ISBN 978-9951-608-59-6



9 789951 608596